



**RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT**  
**MBI**  
**(Auditimin Financiar)**

**“BASHKIA FUSHË ARRËZ”**

**Tiranë, shtator 2025**

<b>PËRMBAJTJA</b>		<b>Faqe</b>
<b>I.</b>	<b>PËRMLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	3-9
1	Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit	3-3
2	Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4-6
3	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	6-7
<b>II.</b>	<b>HYRJA</b>	7-11
1	Objektivat dhe qëllimi	7-7
2	Identifikimi i çështjes	7-7
3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	7-7
4	Përgjegjësitë e audituesve	7-8
5	Kriteret e Vlerësimit	8-9
6	Standardet e auditimit	8-9
7	Metodat e auditimit	9-10
8	Dokumentimi i auditimit	10-11
<b>III.</b>	<b>PËRSHKRIMI AUDITIMIT</b>	11-56
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	11-11
2.	Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit	11-56
2.1	Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditit të brendshëm	12-26
2.2	Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2024, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.	26-46
2.3	Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm	46-51
2.4	Të ndryshme të dala gjatë auditimit	51-52
<b>IV.</b>	<b>GJETJE E REKOMANDIME</b>	52-58

## II. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

### a. Përshkrim i shkurtër për subjektin nën auditim.

Bashkia Fushë Arrëz, pjesë e Qarkut Shkodër është njësi vendore, institucion i pavarur, ku pas ndarjes së re territoriale është një bashkim mes qytetit dhe 5 njësi administrative si vijon: Fushë -Arrëz, (qendra), Fierzë, Blerim, Qafë Mali dhe Iballë.

Bashkia Fushë Arrëz, ndodhet në një zonë malore dhe pyjore me shumë pasuri natyrore, mes kufijve me bashkitë: Tropojë në veri, Vau i Dejës në perëndim, Pukë dhe Mirditë në jugperëndim, dhe Kukës në lindje.

**Historiku i zhvillimit ekonomik:** Bashkia Fushë Arrëz përbëhet nga 5 Njësi Administrative: Fushë -Arrëz, (qendra), Fierzë, Blerim Qafë Mali dhe Iballë dhe zë një sipërfaqe prej 540,42 km<sup>2</sup>. Bashkia ka një numër prej 11,651 banorë. Dendësia e popullsisë është rreth 21,5 banorë/km<sup>2</sup>.

**Misioni** i Bashkisë Fushë Arrëz, është të sigurojë qeverisjen në një nivel sa më afër qytetarëve, duke garantuar vetë-qeverisjen në përputhje me kërkesat e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore.

**Synimi kryesor** është plotësimi sa më i mirë i nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të balancuar me qëllim përfundimtar standarde të larta të cilësisë së jetesës në territorin nën administrim.

**Buxheti i Bashkisë Fushë Arrëz**, si të gjithë njësitë e qeverisjes vendore financohet nga të ardhurat e veta të krijuara në mënyrë të pavarur, nga transfertat e pakushtëzuar e akorduar nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të veta dhe të përbashkëta, nga transfertat e kushtëzuara të akorduara nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të deleguara, nga transfertat specifike për realizimin e funksioneve të reja, nga ndarja e taksave ndërkombëtare, donacione e burime të tjera të parashikuara në ligj.

### b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të *ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 "Për financat e qeverisjes vendore" nenit 50 "Auditi i jashtëm" pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: "1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësi të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë".* Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Fushë Arrëz si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

### c. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare për periudhën 01.01.2024 - 31.12.2024, duke vlerësuar nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

### d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. Metodatat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodatat dhe teknikat e mëposhtme verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren.

**e. Nga shqyrtimi i evidencave**, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 10 gjetje dhe ka dhënë 14 rekomandime, nga ku masa organizative me 9 gjetje dhe 10 rekomandime, 1 gjetje-dhe 4 rekomandime në vlerën 298,886 mijë lekë në fushën e të ardhurave si masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore.

**f. Paraqitja e gjetjeve kryesore.** Disa nga problematikat e konstatuara lidhen me:

***Mbi Menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe funksionimin e NJAB.***

-Auditimi i kryer nga Njësia e Auditimit të Brendshëm ka qenë formal dhe jo analitik, pasi nuk janë përfshirë në programet e auditimeve tërësia e veprimtarisë financiare dhe administrative e institucionit. Subjektet e audituara nuk kanë paraqitur Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve, në zbatim të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015, “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*” dhe Manualit të Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli IV, Pika 4.1.12. Hapi 11, “*Raportet e auditimit dhe plotësimi i plan veprimit nga njësia e audituar*”.

-Programi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Njësinë e Auditimit të Brendshëm për vitin 2024 është hartuar dhe miratuar me urdher nr. 253 datë 21.06.2024, por nuk është dërguar pranë Strukturës Përgjegjëse të Harmonizimit në MF.

***Mbi vlerësimin e pasqyrave financiare 2024.***

- U konstatua se gjendja e llog.26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” në mbyllje të vitit ushtrimor 2024 paraqitet në vlerën 122,100,000 lekë, ku sipas analizës rezulton që kjo llogari nuk ka pësuar ndryshimet e duhura, e cila dhe ka të bëjë me aksionet e Ndërmarrjes së U. K. Këto aksione janë transferuar nga ndërmarrja ekzistuese në SHRUKSH. Rezultoni se në këtë llogari nuk është pasqyruar transferimi i kësaj shoqërie tek shoqëria e krijuar rishtazi. Aksionet e SHRUKSH janë 38,680,000 lekë. Bashkia Fushë Arrëz zotëron 0.86% të këtyre aksioneve ose 332,648 lekë

- Gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, është për vlerën kontabël 9,194,316 lekë. Sipas analizës së kësaj llogarie të rakorduar me degën e thesarit, kjo llogari është për vlerën 11,622,136 lekë dhe është e analizuar sipas objekteve për 42 raste, për vitin 2023 si dhe nuk është bërë çlirimi i garancive për vitin ushtrimor 2024. Gjatë vitit 2024 shuma e likuiduar është 2,100,432 lekë. Rezultoni se janë plotësuar afatet kontraktuale për likuidimin e vlerës së garancisë, nga ditari i marrëdhënieve me Thesarin, por nga Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Shërbimeve, nuk janë marrë masa për zhblokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse.

- Nga auditimi i llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” u konstatua se kjo llogari vazhdon në rritje në vite të njëpasnjëshme në vlera të konsiderueshme e cila progresivisht në 31.12.2024 është në shumën totale prej 298,885,945 lekë. Kjo vlerë përbëhet nga debitorë:

1. Tatimet dhe taksat në vlerën lekë

2. Debitorë nga auditime të mëparshme në vite në vlerën 240,814,111 lekë,

3. Debitorë për pagesat e kopshtit dhe çerdhes për muajin dhjetor 2024, të cilat janë likuiduar në muajin janar 2025.

4. Si dhe vlera prej 6,138,384 lekë që i përket debitorëve të transferuar nga ish-komunat.

Gjatë vitit 2024, zëri i cili ka pësuar ndryshime pra shtesa dhe pakësime ka qenë: debitorët në vite të tatim taksave, ku ka pasur shtesë të debitorëve me vlerën 5,123,540 lekë dhe pakësime me vlerën 1,734,133 lekë. Gjendja e këtij zëri, nga fundi i vitit 2023 në vlerën 48,495,543 lekë është shtuar në fund të vitit 2024 në vlerën 51,884,950 lekë, të cilat konsiderohen të ardhura të munguara në buxhetin e bashkisë Fushë Arrëz.

### ***Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditet e mëparshme.***

-Bashkia Fushë Arrëz nuk ka dërguar raportim mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve në respektim të afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, veprime në kundërshtim me pikën 2 të nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

- Bashkia Fushë Arrëz nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm, pika 5.

a. Nga 7 masa organizative të rekomanduara, rezulton se 1 është zbatuar plotësisht, 4 masa të pazbatuara, 1 është në proces zbatimi dhe 1 masë pjesërisht e zbatuar.

b. Nga 4 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike si dhe uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë detyrimet nga qiradhënia(të ardhura të munguara), rezultoi se:

*Nga 4 masa të rekomanduara, 1 masë e pazbatuar, 2 masa në proces dhe 1 masë zbatuar pjesërisht.*

c. Masa disiplinore, rezulton se janë zbatuar, duke u dhënë 4 vërejtje për 4 punonjës.

Bashkia Fushë Arrëz nuk ka marrë të gjithë masat e nevojshme për zbatimin e plotë të rekomandimeve.

-Niveli i pranimit të rekomandimeve është 100% dhe realizimi në masën 9 % zbatuar, pa zbatuar në nivelin 45,45%, në proces apo zbatuar pjesërisht në nivelin 45,45 %.

### **g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:**

-Bashkia Fushë Arrëz në lidhje me të ardhurat, të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në vlerën **51,884,950** lekë për vitin 2024, nga taksapaguesit të biznesit, institucione shtetërore, fermerë, individë etj.

-Bashkia Fushë Arrëz, të marrë masa për të sistemuar të gjitha llogaritë përkatëse në pasqyrat financiare 2025, të cilat janë edhe rekomandime të mëparshme të lëna nga KLSH, të pazbatuara në pasqyrat financiare 2024.

- Bashkia Fushë Arrëz, të marrë masa dhe të nxjerrë përgjegjësitë për nivelin e ulët të zbatimit të rekomandimeve ku rezultojnë **pa zbatuar në nivelin 45,45%, dhe në nivelin 45,45 % në proces apo zbatuar pjesërisht.**

## **I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit**

### **Opinion mbi pasqyrat financiare**

Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Fushë Arrëz, për periudhën ushtrimore 01.01.2024-31.12.2024, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, kemi konkluduar në **një opinion i pamodifikuar, me theksim çështjeje:**

### **Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare:**

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik dhe Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit”, pjesë e Raportit

Përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura.

Ne besojmë se, evidencat e auditimit që kemi siguruar, janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të marrë siguri të arsyeshme për dhënien e opinionit tonë (ISA 700-ISSAI 1700). Gjithashtu, dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 5,551 mijë lekë për shpenzimet, si dhe anomalitë e mëposhtme:

#### Theksimi i çështjeve:

-Në vlerën e lartë të gjendjes së llogarisë së debitorëve, llogaria 468 “*debitorë të ndryshëm*” ka ndikuar dhe gjendja e debitorëve të krijuar ndër vite nga detyrimet e lindura nga raporte të auditimeve të mëparshme në shumën 240,814 mijë lekë si dhe debitorët nga taksat dhe tarifat vendore në vlerë progresive prej 51,885 mijë lekë.

-Gjendja e llogarisë 26 “*Pjesëmarrje në kapitalin e vet*” në mbyllje të vitit ushtrimor 2024 paraqitet në vlerën 122,100,000 lekë, ku sipas analizës rezulton që kjo llogari nuk ka pësuar ndryshimet e duhura, e cila ka të bëjë me aksionet e NUK. Në këtë llogari nuk është pasqyruar transferimi i kësaj shoqërie tek shoqëria e krijuar rishtazi. Aksionet e SHRUKSH janë 38,680,000 lekë. Bashkia Fushë Arrëz zotëron 0.86% të këtyre aksioneve ose 332,648 lekë.

- Vlera e debitorëve progresivë deri në 31.12.2024, për taksat vendore është 51,885 mijë lekë, e përbërë nga: Debitorë: tatimet dhe taksat në vlerën 23,476,511 lekë; Debitorë institucione publikë-2,097,926 lekë; Debitorë për kontrata qiraje në vlerën 26,310,513 lekë. Shtesa e debitorëve për vitin 2024 në tatim taksat është në vlerën 5,123,540 lekë.

## **I. HYRJA**

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*” dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. **468/1, datë 25.04.2025**, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 28.04.2025 deri në datën 10.06.2025, në subjektin Bashkia Fushë Arrëz u krye “*Auditimi Financiar*” për periudhën 01.01.2024 - 31.12.2024.

Grupi i auditimit përbëhej nga audituesit:

1. E. Ll. – Përgjegjëse Grupi
2. L.GJ. – Anëtar
3. K. F. – Anëtare

### **1. Objektivat e auditimit**

Auditimi Financiar në Bashkinë Fushë Arrëz kishte si objektiva kryesore:

- Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;
- Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuar dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)<sup>1</sup>;
- Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;
- Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

<sup>1</sup>Në zbatim të përcaktimeve të Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

## **2. Qëllimi i auditimit**

Objektivi i auditimit financiar në Bashkinë Fushë Arrëz është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

## **3. Identifikimi i çështjes**

Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Bashkisë Fushë Arrëz dhe përgjegjësi, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:

1. Aktiviteti i Njësisë së Auditit të Brendshëm dhe zbatimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit;
2. Raportimi financiar;
3. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

## **4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese**

Strukturat drejtuese të Bashkisë Fushë Arrëz, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin rregullator të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

## **5. Përgjegjësitë e audituesve**

Përgjegjësia e grupit të auditimit është që të shprehë një opinion në lidhje me pasqyrat financiare në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, të planifikojë dhe të kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit. Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute. Auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozohet që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston.

## **6. Kriteret e vlerësimit**

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Fushë Arrëz është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kriterëve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Fushë Arrëz. *Burimet e kriterëve të vlerësimit janë:*

- *Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;*
- *Ligji nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;*
- *Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;*
- *Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;*
- *Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;*
- *Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar;*

- Ligji Nr. 88/2019, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”;
- “VKM nr. 187, datë 8.3.2017 për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, Zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit”, i ndryshuar.
- VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim;
- Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”;
- Udhëzimi i MFE nr. 10, datë 28.02.2020 “Për përgatitjen e PBA vendor 2021-2023”;
- Udhëzimi MFE nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”;
- Udhëzimin i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”;
- UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar;
- Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”. Etj.

## **7. Standardet e auditimit**

Për kryerjen e Auditimit Financiar në Bashkinë Fushë Arrëz grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë :

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik“;
- ISSAI 200 “Parimet themelore të auditimit financiar”.
- ISSAI 2200-2899 “Standardet e auditimit financiar“;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC.

## **8. Metodologjia e auditimit**

### 1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim.

### 2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin.

### 3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse. Gjithashtu, u krye mbikëqyrje e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

### 4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

### 5. Konfirmim nga të tretët.

Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

### 6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

### 7. Intervistimi

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Fushë Arrëz me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

### 8. Raporte dhe Informacione

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.

#### *Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit*

Mbështetur në standardet ISSAI, audituesit duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare si dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale<sup>2</sup>.

Sa më sipër grupi i auditimit realizoi vlerësimin e materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke përcaktuar nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përlllogarritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga, shpenzime operative dhe investime.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH-ja aplikon<sup>3</sup>.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionit financiar dhe jo financiar; *inspektimeve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ ditarë/ partitarë, ose në trajtë elektronike por edhe inspektime fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; dhe *së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit të personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

## **9. Dokumentimi i auditimit**

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me

<sup>2</sup> ISSAI 1315

<sup>3</sup> Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm \* Risku i kontrollit \* Risku i Zbulimit

standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të auditimit në terren mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, nga grupi i auditimit janë mbajtur akt-konstatimet të cilat u dorëzuar në zyrën e protokollit Bashkia Fushë Arrëz në datë 10.06.2024, e cila korrespondon me datën e mbylljes së punës në terren sipas programit të auditimit nr.468/1 prot., datë 10.06.2024. Nga subjekti i audituar nuk janë paraqitur kundërshti në fazën e PRA-së.

### **III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**

#### **1. Informacioni i Përgjithshëm:**

Auditimi në Bashkinë Fushë Arrëz u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për tu audituar. Në këtë subjekt, u evidentuan disa të meta e dobësi në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në drejtim të raportimit financiar, të menaxhimit të të ardhurave nga taksat e tarifat vendore, menaxhimin, inventarizimin dhe hipotekimin e pronave/aseteve.

Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin dhe realizimin e auditimit, grupi i auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave për shpenzimet dhe të ardhurat e veta, aktivitetet kryesore dhe problematikat e trajtuara nga media, të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.

**Zona Gjeografike:** Bashkia Fushë Arrëz është pjesë e Qarkut Shkodër dhe ndodhet në një zonë malore dhe pyjore me shumë pasuri natyrore, mes kufijve me bashkitë: Tropojë në veri, Vau i Dejës në perëndim, Pukë dhe Mirditë në jugperëndim, dhe Kukës në lindje.

Bashkia Fushë Arrëz përbëhet nga 5 Njësi Administrative: Fushë -Arrëz, (qendra), Fierzë, Blerim Qafë Mali dhe Iballë zë një sipërfaqe prej 540,42 km<sup>2</sup>. Bashkia ka një numër prej 11,651 banorë. Dendësia e popullsisë është rreth 21,5 banorë/km<sup>2</sup>.

**Rëndësia e këtij auditimi** është sepse, auditimi është pjesë jetike e një sistemi rregullator, që ka për qëllim të vlerësojë dhe evidentojë shkeljet e parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar, si edhe shfrytëzimin me eficiencë, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike. Ky sistem bën të mundur që subjekti i audituar të ndërmarrë veprimet korrigjuese sipas rastit, të rritë përgjegjshmërinë në llogaridhënie, rikuperimin e dëmeve të shkaktuara, si dhe parandalimin e shkeljeve me synim rritjen e vlerës së parasë publike në mbrojtje të interesave të taksapaguesve

#### **II. 1. Auditimi i vlerësimit të funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditit të brendshëm.**

II.1.1 Mbi Identifikimin dhe vlerësimin e nivelit të implementimit të komponentëve të MFK. Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike për periudhën e aktivitetit viti 2024.

#### **Baza ligjore**

-Ligji nr.10296/2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar;

-Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;

-Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar;

*-Ligji nr.7961 /1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar;*

*-Ligji nr.68/2017 “Për financat e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”;*

*Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i ndryshuar*

*-Ligji “Për menaxhimin e sistemit buxhetor të RSH”;*

*-VKM nr.243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar me VKM nr.746/2018;*

*-VKM nr. 833 datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”;*

*-Udhëzimi nr. 15 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”;*

*Urdhri i Ministrisë së Financave Nr.04., datë 26.01.2024 “Për miratimin e manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit”*

*Urdhrit të Ministrisë së Financave nr.2., datë 26.01.2024 ‘Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike’*

Ky auditim u krye për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga stafi i Bashkisë Fushë-Arrëz, rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

### **1.Komponenti “Mjedisi i kontrollit”**

Ky komponent përfshin integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike, politikat menaxheriale dhe stilin e punës, strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit, politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore, aftësitë profesionale të punonjësve.

#### **Parimi 1 - Njësia Publike demonstroi angazhim për integritet dhe vlerat etike**

Nëpërmjet këtij parimi është vlerësuar angazhimi i Bashkisë Fushë-Arrëz në hartimin dhe zbatimin e elementëve dhe mekanizmave të nevojshëm për zhvillimin e integritetit dhe vlerave etike në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

-Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi se bashkia vepron mbi bazën e rregullores së brendshme miratuar me Vendimin nr. 1797/1.prot., datë 26.07.2017 “Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Fushë-Arrëz”. Në këtë dokument, janë përcaktuar parimet, funksionimi, kompetencat dhe detyrat për strukturat e institucionit. Bashkia Fushë-Arrëz ka miratuar kodin e etikës me shkresën nr.1051.prot., datë 08.04.2025.

#### **Konstatohet se rregullorja është ri parë në vitin 2025 me Vendim nr.11, datë 08.04.2025.**

Struktura organizative e Bashkisë Fushë-Arrëz është miratuar me Vendim Nr.34.prot, datë 29.12.2023 në zbatim të urdhrit nr. Urdhër Nr.615/1 datë 15.12.2023. Struktura e Bashkisë Fushë-Arrëz është e përbërë nga 304 punonjës nga të cilat 19 vende janë vakante. Struktura përmban 46 punonjës me status të nëpunësit civil nga të cilët me shërbim civil janë vetëm 9 punonjës. Me urdhrin nr. 615/2 datë 10.09.2024 është ndryshuar struktura dhe niveli i pagave,

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga drejtorja e burimeve njerëzore rezulton se në rregulloren e brendshme përfshihen vetëm **149** pozicione pune të strukturës aktuale përkatësisht:

1. **8** pozicione pune me statusin funksionar politik;
2. **1** pozicion pune me statusin i zgjedhur;
3. **46** pozicione pune me status të nëpunësit civil;
4. **94** pozicione pune me kontratë.

-Bashkia Fushë-Arrëz ka Kod Etike i cili është miratuar në vitin 2025. Për zbatimin e tij bashkia mbështetet në ligjin nr. 9131 datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, ligji nr. 9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar si dhe ligje apo rregulloret specifike që janë krijuar në bazë të një ligji specifik.

-Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se nuk ka asnjë procedurë për raportimin e shkeljeve të rregullave mbi etikën dhe për marrjen e masave si rrjedhojë e kësaj. Janë miratuar programet e trajnimit të punonjësve lidhur me njohjen e ndryshimeve në bazën rregullatorë apo kodin e etikës.

Rregullorja e brendshme nuk është publikuar në faqen WEB-it dhe publikuar në <https://bashkiafushearrez.gov.al/portfolio-grid.html>.

- Bashkia nuk ka miratuar një plan strategjik me objektiva dhe prioritete në përputhje me kërkesat e ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor.

-Me Vendimin nr. 34, datë 29.12.2023 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Fushë-Arrëz” për vitin 2024, titullari ka miratuar strukturën e përbërë nga **281 (dyqind e tetëdhjete e një)** punonjës në total. Në këtë strukturë përfshihen pozicione pune për funksionet e deleguara e të transferuara që janë **149** (njëqind e dyzet e nëntë).

Kjo strukturë ka ndryshuar me vendimin nr. 11, datë 29.03.2024 me strukturë të përbërë prej 304 punonjësish. Me vendimin nr. 48, datë 30.9.2024, e përbërë nga **304 (treqind e katër)** punonjës. Vendimi është protokolluar me nr.3114.prot., datë 01.10.2024. Përgjatë vitit 2024 janë larguar **28** punonjës si dalje në pension largime vullnetare.

Tabela nr.1: Struktura e Bashkisë Fushë-Arrëz për vitin 2024

Numri i të punësuarve në strukturën e miratuar	<b>304</b>	Nëpunës Civilë	<b>9</b>
		Nëpunës me kontratë	<b>285</b>
		Të zgjedhur	<b>2</b>
		Funksionar Politikë	<b>8</b>

Burimi: Drejtorja e Burimeve Njerëzore Fushë-Arrëz, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Struktura prej 304 punonjësish përbëhet nga 46 vende me shërbim civil nga të cilat 9 janë të plotësuar me punonjës të shërbimit civil dhe 37 punonjës nuk janë të pajisur me status të nëpunësit civil megjithëse vendi i punës e kërkon këtë kriter.

-Nga auditimi konstatohet se nuk është rishikuar rregullorja e brendshme gjatë vitit 2024 në përputhje me ndryshimet strukturore por është ndryshuar me Vendimin nr.11 datë 8.4.2025 e për rrjedhojë pas hartimit të kësaj rregulloreje çdo drejtori, sektor apo njësi ka përgjegjësi dhe detyra të mirë përcaktuara në rregulloren e vitit 2025. Rregullorja e re është protokolluar me nr.1049.prot., datë 09.04.2025

**Gjatë vitit 2024** me urdhrin nr.15.prot., datë 19.01.2024 është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) për programin buxhetor afatmesëm 2025-2027.

GMS luan një rol kyç për sa i takon integritetit të informacionit financiar të njësisë publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike. Ai ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësisë si dhe përkujdeset për performancën e njësisë publike. Bashkia Fushë-Arrëz zhvillon takimet e GMS, të dokumentuara me procesverbale.

Me VKB nr.12.prot., datë 29.03.2024 janë miratuar PBA 2025-2027 miratimi i tavaneve faza e parë e protokolluar me nr,1070.prot., datë 08.04.2024

Me VKB nr. 34.prot., datë 28/08/2024 është miratuar PBA -2025-2027, protokolluar me nr.2771.Prot., datë 02.09.2024 miratuar me nr.593/1.prot., datë 16.09.2024 nga prefekti i qarkut Shkodër, protokolluar me nr.2987.prot., datë 18.09.2024.

Për vitin 2024, është përcjellë në MF “Deklarata për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë Bashkia Fushë-Arrëz me nr. 441.Prot, date 13.02.2024 dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm”.

Buxheti i bashkisë për vitin 2025 është miratuar me shkresën VKB nr.64.prot., datë 23.12.2024 konfirmuar nga prefekti i qarkut me shkresën nr.5/1. Datë 13.01.2025.

Nga auditimi i kryer në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe të dhënave të pyetësorit të vetëvlerësimit u konstatua si më poshtë vijon:

- Punonjësit nuk informohen në lidhje me ligjet dhe rregulloret e brendshme dhe nuk ka një proces të qartë për mënyrën e informimit të punonjësve.
- Nuk ka një procedurë të saktë për raportimin e shkeljeve të rregullave mbi etikën dhe për marrjen e masave si rrjedhojë e kësaj.
- Bashkia Fushë Arrëz nuk ka një program trajnimi të dedikuar për integritetin dhe sjelljen etike
- Nuk ekzistojnë mekanizma të cilat i dedikohen ankesave për korrupsion,
- Bashkia Fushë Arrëz nuk ka një proces për të vlerësuar performancën e personelit dhe ekipeve për shkeljet e kodit të etikës/rregullave të etikës.
- Bashkia Fushë Arrëz nuk ka (Bord/Këshill) për projektimin, zbatimin dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike (për të gjithë komponentët).
- Punonjësit nuk janë trajnuar mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin gjatë periudhës së raportimit viti 2024.
- Nuk ka një dokument për të përcaktuar përgjegjshmërinë dhe përgjegjësinë e menaxherëve për objektivat strategjike.
- Nga auditimi i mjedisit të kontrollit mbi zbatimin e këtij parimi rezulton se mjedisi i kontrollit nuk është pozitiv, rrjedhimisht i gjithë sistemi i kontrollit të brendshëm është efektiv.

*Mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:*

-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a, b, c, ç, d, dh ,e, ë, Kreu III, neni 20.

“Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i miratuar me Urdhri i Ministrisë së Financave Nr.04., datë 26.01.2024, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.1, Kapitulli IV “Plani i veprimit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit”, Kapitulli V, Anekset.

*Për sa më sipër mban përgjegjësi*

*Z. H.C. Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz*

## **2. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”**

Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes.

- Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2024-2026 ka kaluar ne fazat përkatëse ligjore duke u finalizuar ne Vendimin nr. 35, date 29.12.2023

Nga të dhënat e pyetësorëve të dërguar dhe plotësimit të vetëvlerësimit të MFK-së u konstatua si më poshtë vijon:

- Bashkia Fushë Arrëz nuk ka një plan- veprime vjetore operationale të miratuara për arritjen e qëllimeve dhe politikave afatmesme dhe objektivave vjetore që të përmbajnë veprime, afate dhe persona konkretë përgjegjës për çdo veprim të parashikuar.

- -Nga auditimi mbi zbatimin e këtij parimi rezulton se bashkia nuk ka përcaktuar mekanizma të organizuar dhe funksionalë të procesit të menaxhimit të riskut.
- Nuk ka një sistem raportimi për shkeljet e rregullave në fuqi apo raste të raportimit mashtrues, shënime fiktive, humbja e pasurive, korrupsioni që vihen re në njësi.
- Bashkia Fushë Arrëz nuk ka marrë në konsideratë gjatë vitit 2024 ndikimet e mundshme të riorganizimit, shtimit të njësive të reja organizative dhe/ose ndryshimet e menjëhershme të strukturave ekzistuese në sistemin e kontrollit të brendshëm.
- Risku i mashtrimit nuk është pjesë përbërëse e procesit të rregullt të vlerësimit të riskut.
- Nuk është përcaktuar, gjatë vlerësimit, ndikimi i mundshëm i një risku direkt në realizimin e treguesit të performancës ose indirekt në arritjen e një objekti specifik.
- -Nuk është hartuar strategjia, ndërsa regjistri i risqeve është hartuar por nuk është protokolluar ku të përfshihen të gjitha strukturat e Bashkisë Fushë-Arrëz si dhe në monitorimin dhe raportimin në mënyrë periodike të risqeve me impakt të lartë me qëllim menaxhimit efektiv të tyre.
- Vlerësimi i riskut të mashtrimit nuk është pjesë përbërëse e procesit të rregullt të vlerësimit të riskut;
- -Titullari i bashkisë nuk ka ngritur Urdhër për përcaktimin e grupit koordinues teknik për procesin e menaxhimit dhe raportimit mbi risqet e për rrjedhojë nuk ka as raportime tek menaxherët e risqeve;
- Nuk ka plan-veprime për menaxhimin e riskut;
- -Nga auditimi evidentohet se Bashkia Fushë-Arrëz nuk vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime dhe nuk kryen vlerësime periodike të ekspozimit ndaj këtyre risqeve për shkak të mungesës së aftësisë parashikuese, angazhimit dhe ndërgjegjësimit mbi përfitimet e këtij procesi. Nuk ka një sistem raportimi për shkeljet e rregullave në fuqi apo raste të raportimit mashtrues;
- -Bashkia Fushë-Arrëz nuk ka marrë në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni për vitin 2025 për rrjedhojë këto ndryshime strukturore apo menaxheriale nuk janë ndjekur nga ndryshime në rregulloren e brendshme. Përmirësimet në përshtatje me pozicionet e punës dhe përshkrimet e punës në rregulloren e brendshme janë hartuar gjatë vitit 2025;
- -Nga auditimi konstatohet se është rishikuar rregullorja e brendshme në përputhje me ndryshimet strukturore me Vendim nr.11, datë 8.04.2025 e për rrjedhojë për çdo drejtori, sektor apo njësi, përgjegjësi dhe detyra të mire përcaktuara protokolluar me nr.1036.prot., datë 08.04.2025;
- -Nga auditimi mbi zbatimin e këtij parimi rezulton se efektiviteti i sistemit të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivel të ulët.

*Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:*

-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a, b, c, ç, d, dh, e, ë, Kreu III, neni 21, pika 2;

-Udhëzimi nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 3 “Përgjegjësitë dhe detyrat e KR”, pika 3.2.1 “Titullari i njësisë publike” pika 4 “Hapat për ngritjen e sistemit të MR”

-“Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i miratuar me Urdhër të Ministrisë së Financave Nr.04., datë 26.01.2024 “Për miratimin e manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit” Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.2, Kapitulli V, Anekset.

*Për sa më sipër mban përgjegjësi*

*Z. H. C. Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz*

*Znj. E. E. koordinatorë e riskut*

### **3. Komponenti: “Aktivitetet e Kontrollit”**

Veprimtaritë e Kontrollit përfshijnë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut. Aktivitetet e kontrollit duhet të integrohen tek proceset dhe sistemet, në momentin që këto procese dhe sisteme krijohen. Futja e aktiviteteve të kontrollit në një fazë të mëvonshme është më e kushtueshme dhe më pak efektive.

*-Në vijim të auditimit të kryer, mund të themi se ka problematika për t’u adresuar, të cilat lidhen kryesisht me mungesën e hartave apo manualeve të proceseve të punës për vitin 2024 dhe sjellin si pasojë mbivendosjen e detyrave dhe përgjegjësi.*

Përgatitja e një harte me proceset e punës garanton uniformitetin në kryerjen e proceseve të punës, identifikimin e aktiviteteve të kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda të cilave këto aktivitete duhet të kryhen së bashku me një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit që identifikohen brenda një procesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave të tij. Nga komunikimi me punonjësit e Drejtorisë së Burimeve rezulton se ekzekutimi dhe regjistrimi i transaksioneve financiare nuk bëhen nga i njëjti person. Detyrat janë të ndara. Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga nëpunësi zbatues, regjistrohet nga specialisti i buxhetit dhe miratohet nga nëpunësi zbatues. Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga specialisti për kontabilitetin dhe autorizimi i pagesës kryhet nga nëpunësi autorizues.

-Në zbatim të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, bashkia ndjek procedurat për organizimin e prokurimeve, kanë komisione për prokurim, komisione për hartimin e specifikimeve teknike, komisionin e vlerësimit të ofertave, komisionin për pranimin e mallit etj..

-Në zbatim të Udhëzimit nr. 01 datë 05.01.2018 “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të PP dhe krijimi i tyre në sistemin e PP” është hartuar dhe miratuar regjistri i prokurimeve.

-Bashkia Fushë-Arrëz ka krijuar një regjistër aktivesh i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet.

Nga të dhënat e pyetësorëve të dërguar dhe plotësimit të vetëvlerësimit të MFK-së u konstatua si më poshtë vijon:

- Nuk ka procedura të mirë përcaktuara për ruajtjen, përdorimin dhe arkivimin e dokumentacionit.
- Bashkia Fushë Arrëz nuk ka sisteme funksionale të TI-së, të ndryshme nga ato që janë fikse? (pra përveç sistemeve qeveritare si APP, SIFQ, PBA, HRMIS etj.) Nuk janë vendosur procedurat për të siguruar vazhdimësinë e veprimeve kundrejt risqeve kryesore që mund ta pengojnë këtë veprimtari për humbjen e të dhënave informatike.
- Bashkia Fushë Arrëz nuk ka procedura të përshtatshme për sigurinë e sistemit (TI dhe të ndryshme) që aktivitetet dhe të dhënat ruhen nga ndërhyrjet e paautorizuara
- Nuk ka ndarje të detyrave në funksionimin e sistemeve të TI-së në njësinë publike, me qëllim që të parandalohet që një punonjësi i vetëm të kontrollojë të gjitha fazat e funksionimit të TI-së. Institucioni nuk ka një sistem rezervë (back-up) TI të përshtatshëm, plan rikuperimi nga fatkeqësitë të testuar në praktikë.
- Bashkia Fushë-Arrëz nuk ka sisteme funksionale të IT-së të ndryshme nga ato fikse (pra përveç sistemeve qeveritare si APP, SIFQ, SMBV, HRMIS).
- Nga auditimi rezulton se bashkia nuk ka një procedurë të rikuperimit dhe të ruajtjes, back-up- it. Bashkia Fushë Arrëz nuk ka procedura të shkruara specifike për vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve. Bashkia Fushë Arrëz nuk ka të mirë përcaktuara procedurat e kontrollit të miratuara nga nëpunësi autorizues lidhur me :  
a) integritetin e të dhënave financiare, konkretisht detyrimi për rakordimet mujore të

llogarive (arkë, thesar, bankë); rakordimin dhe pastrimin e llogarive kontabël pezull dhe të paradhënëve.

- b) sigurinë e të dhënave financiare si qasjen në të dhënat kontabël (kush ka të drejtë vetëm leximin e të dhënave dhe kush dhe kur regjistron/ndryshon të dhënat)
- -Nga të dhënat e vëna në dispozicion, rezulton se ka sektor qe kane hartë dhe manual të proceseve të punës.
- -Për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat. Nuk ka asnjë procedurë të miratuar nga titullari dhe gjurmë auditi për inventarizimin, tjetërsimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktivëve afatgjata materiale. Procedurat për inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit bëhen duke u bazuar në udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike” i ndryshuar, por duhet theksuar fakti se për periudhën na fjalë nuk ka dalje jashtë përdorimi.

#### **Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:**

-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a, b, c, ç, d, dh, e, ë, Kreu II, neni 16, pika 2, Kreu III, neni 22, pika 1;

-Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 5.2.7 “Monitorimi dhe Raportimi”;

-“Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i miratuar me ” i miratuar me Urdhër të Ministrisë së Financave Nr.04., datë 26.01.2024, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.3, Kapitulli V, Anekset.

*Për sa më sipër mban përgjegjësi*

*Z. H. C. Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz*

#### **4. Komponenti: “Informimi dhe komunikimi”**

Informimi dhe komunikimi përfshin identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e një informacioni të vërtetë dhe të besueshëm në një format të përshtatshëm, brenda afateve të duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse.

Komunikimi me taksapaguesit, furnitorët e shërbimeve, rregullatorët dhe palët e tjera të jashtme është gjithashtu thelbësor për kontrollin e brendshëm efektiv. Informacioni është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen efektive të detyrave të ngarkuara.

Rëndësia e kanaleve të informacionit dhe komunikimit me të cilat informacionet transferohen mund të shihet drejtpërdrejt në procesin e vendimmarrjes. Cilësia e një vendimi të marrë është e kushtëzuar nga cilësia e informacionit në drejtim të kohës, përshtatshmërisë, saktësisë dhe disponueshmërinë.

-Institucioni realizon konsultime publike me qytetarët dhe grupet e interesit për çështje që lidhen me përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Për vitin 2024 janë zhvilluar 5 dëgjesa publike në Bashkinë Fushë-Arrëz. Dëgjesa Publike janë zhvilluar në lidhje me Paketën Fiskale dhe Projekt Buxhetin për vitin 2025 sipas kalendarit të mëposhtëm:

- Njësia Administrative Iballe, në datë 18.11.2024 ora 13.00
- Njësia Administrative Blerim, në datë 31.10.2024 ora 14.00
- Njësia Administrative Qafe Mali, në datë 19.11.2024 ora 13.00
- Njësia Administrative Fierzë, në datë 31.10.2024 ora 10.00
- Bashkia Fushë-Arrëz, në datë 14.11.2024 ora 11.00

Bashkia Fushë Arrëz nuk ka një sistemi të vet të mbajtjes së kontabilitetit dhe të dhënat mbahen në Excel gjë që përben risk në lidhje me garantimin e ruajtjes dhe mos ndryshueshmërisë të të dhënave.

Bashkia Fushë Arrëz nuk ka procedurë për të siguruar që menaxherët dhe personeli i njësisë publike të informohen për vendimet/projektet/nismat e njësive të tjera, që mund të ndikojnë në përgjegjësitë dhe detyrat e tyre.

Punonjësit e Bashkisë Fushë-Arrëz nuk kanë të gjithë email zyrtar.

-Bashkia Fushë Arrëz nuk ka siguruar qasje publike nëpërmjet publikimit rregullisht në faqen e internetit të njësisë të informacionit:

Nga verifikimi në faqen zyrtare <https://bashkiafushearrez.gov.al> në ikonën transparenca në linqun <https://bashkiafushearrez.gov.al/portfolio-grid.html> nuk janë publikuar

1)Dokumentet e Buxhetit vjetor të propozuar;

2)Buxheti i miratuar për njësinë;

3)Raportet periodike të zbatimit të buxhetit

4)Pasqyrat vjetore financiare dhe të buxhetit

5)Plani/et vjetore të prokurimit; proceset e hapura të prokurimit; kontratat e lidhura; statistika mbi prokurimet;

6)Raporti i Auditimit të jashtëm për njësinë mbi pasqyrat financiare dhe aktivitetin e vitit paraardhës.

Nga auditimi u konstatua që punonjësit nuk janë të informuar rregullisht në lidhje me veprimtarinë e institucionit si dhe publiku nuk ka qasje të plotë për informim në faqen zyrtare të bashkisë.

**Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:**

-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a, b, c, ç, d, dh, e, ë, Kreu III, neni 23, “Informacioni dhe Komunikimi” pika 2; Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” neni 4; neni 8.

“Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i miratuar me Urdhër të Ministrisë së Financave Nr.04., datë 26.01.2024, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.4, Kapitulli IV, Aneksat.

*Për sa më sipër mban përgjegjësi*

*Z. H. C. Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz*

## **5. Komponenti: “Monitorimi”**

Monitorimi realizohet përmes monitorimit në vijueshmëri, vetëvlerësimit dhe auditimit të brendshëm.

Procesi i monitorimit duhet të përfshijë vlerësimin e vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kohë dhe me kosto efektive. Vlerësime të herëpashershme të këtyre sistemeve duhet të kryhen sipas nevojës.

-Nga auditimi i kryer, konstatohet se në institucion janë përcaktuar në rregulloren e brendshme rregullat bazë për raportimin e ecurisë dhe statusit të implementimit të objektivave. Rregullorja është rishikuar rregullorja me Vendim nr.11. date 8.04.2025 dhe janë hartuar manualët e proceseve të punës, ku të jenë përcaktuar të gjithë proceset e detajuara në afate kohore dhe për persona përgjegjës për zbatimin dhe raportimin e tyre.

-Bashkia Fushë-Arrëz monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit e kryen nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, dokument i cili është dërguar në Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit me nr.368.prot, date 6.02.2024 , pranë MFE.

-Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, realizohet edhe nëpërmjet shërbimit të Auditimit të Brendshëm, performuar nga Njësia e Auditit të Brendshëm . NJAB ka kryer auditim mbi MFK i cili është formal dhe pa u thelluar analitikisht për çdo subjekt të audituar. Nga auditimi i kryer në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe të dhënave të pyetësorit të vetëvlerësimit u konstatua si më poshtë vijon:

-Bashkia Fushë-Arrëz nuk ka hartuar një dokument të mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit, gjë e cila mund të shkaktojë uljen e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm në këto njësi.

-NJAB ka hartuar planin strategjik të auditit të brendshëm, raportin vjetor dhe raportet e auditimit për çdo auditim të kryer përgjatë vitit 2024.

-Në bazë të auditimit të kryer, titullari i institucionit, për rekomandimet e lëna nga KLSH ka ndërmarrë masa korigjuese, nëpërmjet plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve ku caktohen afatet dhe personat përgjegjës për zbatimin e këtij plani. Një pjesë e konsiderueshme e detyrave kanë gjetur zbatim.

Bashkia Fushë Arrëz nuk ka rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Bashkia Fushë Arrëz nuk ka një urdhër të miratuar për një plan veprimi të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, të miratuar për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Personeli nuk njofton çështjet e kontrollit të brendshëm përmes linjave të raportimit të përcaktuara për palët e duhura të brendshme dhe të jashtme, në kohën e duhur për t'i mundësuar njësisë publike që të vlerësojë menjëherë ato.

Nga auditimi u konstatua që nuk është ngritur një sistem për monitorimin e menaxhimit financiar dhe të kontrollit, me qëllim vlerësimin lidhur me funksionimin e duhur dhe garantimin e përditësimit të tij, sa herë që ndryshojnë kushtet.

### **Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:**

-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a, b, c, ç, d, dh, e, ë, Kreu III, neni 24, “Monitorimi” pika 1;

-“Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i miratuar me Urdhër të Ministrisë së Financave Nr.04., datë 26.01.2024, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.5, Kapitulli V, Aneksat.

*Për sa më sipër mban përgjegjësi*

*Z. H. C., Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz*

### **II.1.2 Auditimi i njësisë së auditit të brendshëm dhe vlerësimi mbi veprimtarinë e saj.**

Dokumentacioni që u analizua për të vlerësuar veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm është si vijon:

-Karta e Auditimit të Njësisë AB të Bashkisë Fushë-Arrëz;

-Plani Strategjik dhe vjetor, si dhe pasqyrat shoqëruese;

-Programimi i auditimeve për vitin 2024;

-Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm;

-Dosjet e përhershme të subjekteve të audituara;

-Rekrutimi i punonjësve në Njësinë e Auditit të Brendshëm, dhe ngritja e nivelit profesional të tyre.

-Vlerësimi i auditimeve.

Auditimi u krye referuar akteve ligjore e nënligjore si më poshtë:

-Ligji Nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar;

-Ligji Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat”;

-VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”;

-Manuali i “Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik” miratuar me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016;

-Udhëzimi Nr.42, datë 27.10.2020 “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”;

-Urdhri nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me urdhrin nr.100, datë 25.10.2016”;

-Normat Teknike Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.

Urdhri nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm”, miratuar me urdhrin nr.100,

datë 25.10.2016 pika 2.2.2 .përcakton detyrat e Njesisë së auditit të brendshëm si vijon: “Njësitë e Auditimit të Brendshëm Njësitë e Auditimit të Brendshëm kanë për detyrë : a) Hartimin e planeve strategjike dhe vjetore të auditimit të brendshëm, bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, si dhe kryerjen e auditimeve në përputhje me planet e miratuara; b) Vlerësimin e përshtatshmërisë dhe efektivitetit të sistemeve dhe kontrolleve të brendshme, duke u fokusuar kryesisht në: i. Identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga titullari i njësisë publike; ii. Përputhshmërinë e veprimtarisë së njësisë publike me kuadrin rregullator; iii. Ruajtjen e aseteve të njësisë publike; iv. Besueshmërinë dhe gjithë përfshirjen e informacionit financiar dhe operacional të njësisë publike; v. Kryerjen e veprimtarisë së njësisë publike me ekonomi, efektivitet dhe eficiencë; vi. Përmbushjen e detyrave dhe arritjen objektivave e qëllimeve; c) Dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike; d) Ndjekjen e zbatimin e rekomandimeve të dhëna”

Auditimi u fokusua kryesisht në këto çështje:

-Organizimi dhe funksionimi i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm/ niveli profesional i audituesve, certifikimi i tyre dhe trajnimet e detyrueshme, bashkëpunimi me Drejtorinë e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, niveli i raportimit në këtë drejtori,

-Realizimi i treguesve të planifikuar nga DAB,

-Sigurimi i cilësisë së auditimit, me qëllim vlerësimin nëse veprimtaria e auditit të brendshëm është në përputhje me kriteret ligjore dhe standardet e auditimit, konkretisht *Ligjin Nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, “Manualin e Auditimit të Brendshëm”, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100 datë 25.10.2016, Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.*

Nga auditimi i kryer mbi funksionimin e FNJAB të Bashkisë Fushë-Arrëz, rezultoi se:

➤ **Organizimi dhe funksionimi:** Bazuar në VKM nr. 83, datë 03.02.2016, “Për miratimin e kriterëve për ngritjen e NJAB në sektorin publik” Bashkia Fushë -Arrëz ka ngritur NJAB.

**Për vitin 2024** NJAB ka funksionuar me 1 (një) Përgjegjës të Sektorit të Auditimit dhe me 2 (dy) Specialistë. Auditimi sipas strukturës organizative të përcaktuar nga Titullari i Bashkisë me vendim nr. 34, datë 29.12.2023 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Fushë-Arrëz” për vitin 2024, e cila është ndryshuar me vendimin nr. 11, datë 29.03.2024 si dhe me vendimin nr. 48, datë 30.9.2024.

Pra, struktura e miratuar me VKB-në nr.34, datë 29.12.2023 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Fushë-Arrëz” për vitin 2024, e cila është ndryshuar me vendimin nr. 11, datë 29.03.2024 si dhe me vendimin nr. 48, datë 30.9.2024, është në mbështetje të VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë të auditimit të brendshëm në sektorin publik” pika 3 e cila përcakton se: “Njësia e Auditimit të Brendshëm përbëhet nga jo më pak se 3(3) punonjës, përfshirë drejtuesin e njësisë. Në strukturën e Njesisë së auditimit të brendshëm mund të punësohen deri 1/3 e punonjësve të pa certifikuar si auditues të brendshëm në sektorin publik.”

Detyrat dhe kompetencat e NJAB janë përcaktuar në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Fushë-Arrëz, e miratuar me vendim nr. 11 datë 08.04.2025 për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e administratës së Bashkisë Fushë-Arrëz” mbi bazën e të cilës funksionojnë të gjitha strukturat e Bashkisë.

Struktura e NJAB, niveli i arsimit, certifikimi, përvoja dhe trajnimet e audituesve paraqiten sipas tabelës se mëposhtme:

Tabela nr.2: Struktura e NJAB

Nr.	Periudha 2024	Funksioni	Arsimimi	Vjetërsi në punë	Vjetërsi në auditim/vite	Certifikimi	Trajnime vijueshme
1	E. P.	Drejtuës	I lartë Master Shkencor	13	4	2023	PO

Nr.	Periudha 2024	Funksioni	Arsimimi	Vjetërsi në punë	Vjetërsi në auditim/vite	Certifikimi	Trajnime të vijueshme
2	L. Ç.	Audituese	I lartë Master Shkencor	6	6	2023	PO
3	D. Gj.	Audituese	I lartë Bachelor	1	1	JO	PO

Burimi: Drejtoria e auditimit të Brendshëm Bashkia Fushë Arrëz

Nga verifikimi i dokumentacionit të dosjes të punonjësit të strukturës së Auditit të Brendshëm rezulton se Përgjegjësi i Sektorit të Auditimit të Brendshëm është certifikuar dhe ka ndjekur në mënyrë të vazhdueshme trajnime e vijueshme për kualifikimin profesional, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” nenet 11, “Punësimi i Auditit të Brendshëm” neni 19 “Certifikimi i audituesve të brendshëm” dhe neni 20 “Trajnimi i vijueshëm profesional i audituesve të brendshëm”.

- **Karta e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik**

NJAB në mbështetje të Urdhrit nr.100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” ka hartuar “Kartën e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” në Bashkinë Fushë-Arrëz, e cila është miratuar nga titullari me urdhrin nr. 150, datë 09.04.2024.

- **Planet Strategjike dhe Vjetore:**

Në mbështetje të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik janë hartuar dhe miratuar planet strategjike sipas viteve:

**Për vitin 2024** me shkresën nr. 3049, datë 18.10.2023 është miratuar plani strategjik për vitet 2024 - 2026 dhe plani vjetor i auditimeve për vitin 2024.

Plani Vjetor 2024 dhe Plani Strategjik për vitet 2024 - 2026 është dërguar zyrtarisht (por edhe me postë elektronike) në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr.3049/1.prot, datë 18.10.2023 në përputhje me Ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, si dhe urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar .

Njësia e AB në Bashkinë Fushë-Arrëz mbulon me auditim 14 subjekte: ku **2 subjekte** janë, si Qendra Kulturore e Fëmijëve e Bashkisë, Sektori i MZSH (Mbrojtjes nga Zjarri e Shpëtimi), **7 subjekte** janë sektorë brenda bashkisë si Sektori i Financës, Sektori i Çështjeve Juridike dhe Prokurimeve, Sektori i Tatim-Taksave, Sektori i Planifikimit të Territorit, Sektori i Policisë Bashkiake, Sektori i Emergjencave Civile dhe Sektori i Burimeve Njerëzore, si edhe **2 subjekte Njësi Administrative** në juridiksionin e Bashkisë Fushë-Arrëz si: NJA Blerim, NJA Fierzë, dhe **3 auditime** janë për secilin vit mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Njësia e Auditit të Brendshëm në hartimin e këtyre planeve është fokusuar në prioritetin e risqeve të identifikuar, dhe ka marrë në konsideratë respektimin e frekuencës së kryerjes së auditimeve.

- **Realizimi i Planeve Vjetore:**

**Për vitin 2024** janë parashikuar gjithsej 4 auditime në Bashkinë Fushë-Arrëz, ku sipas llojit janë të përputhshmërisë dhe të zbatimit rekomandimeve të vitit 2024.

Për vitin 2024 në planin vjetor të miratuar me shkresën nr. 3049.prot, datë 18.10.2023 dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Njësia e auditimit të brendshëm ka planifikuar 4 auditime gjithsej,

Janë realizuar gjithsej 4 misione auditimi në 4 subjekte auditimi, ku 3 janë auditime të planifikuara, 1(një) mision auditimi është për zbatim rekomandimesh të periudhës 2022-2023.

Realizimi i matur duke marrë parasysh auditimet e realizuara në raport me auditimet e planifikuara në numër është në masën 100 %.

Tabela nr.3: Realizimi e auditimeve.

Nr,	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT						
		Auditime të planifikuara	Auditime të realizuara	Nga te realizuarat, sipas llojit				
				Përputh	Financë	Kombinuar	Performancë	Zb.Rek

Drejtoria e auditit të brendshëm nuk ka përfshirë në auditim me nivel risku të lartë auditimet financiare në kundërshtim me Urdhrin nr.4, datë 10.01.2020 a) Hartimin e planeve strategjike dhe vjetore të auditimit të brendshëm, bazuar në vlerësimin objektiv të riskut.

**Raportimi:** Për veprimtarinë e NJAB Në Bashkinë Fushë-Arrëz për periudhën objekt auditimi, është raportuar në mënyrë sistematike. Janë hartuar dhe dërguar në NJQHAB të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë raportet periodike vjetore të shoqëruara këto me evidencat e raportimit në mënyrë progresive dhe vlerësimin përmbyllës për veprimtarinë e NJAB, përkatësisht: Me shkresën nr.233.prot, datë 29.01.2025, është dërguar Raporti Vjetor i Veprimtarisë së NJAB, Bashkia Fushë-Arrëz për vitin 2024.

**Tabela nr.4:** Të dhënat për realizimet e angazhimeve nga AB për auditimet e kryera në vitin 2024

Nr.	Subjektet e Audituar	Realizimi i angazhimeve të auditimit								Statusi i Angazhimit		
		Auditime të realizuara sipas llojit të tyre									Angazhime të përfunduara	Angazhime në proces
		Gjithsëj	Shërbime të Sigurisë nga të cilat:					Shërbime Këshillimi	Angazhime me kërkesë të titullarit			
A. të përputhshëm	A. të performancë		A. financiare	A. tek. Informacionit	A. të kombinuara							
1	Sektori i Financës	1	1							1		
2	Sektori i Çështjeve Juridike dhe Prokurimeve	1	1							1		
3	Sektori i Tatim-Taksave	1	1							1		
4	Zbatim Rekomandimesh	1								1		

➤ **Gjetje-Rekomandimet**

**Për vitin 2024,** Nga auditimet janë evidentuar 25 gjetje, për të cilat janë dhënë 25 rekomandime, nga të cilat 1 rekomandime për përmirësimin e sistemit, 3 rekomandime për përmirësimin e kuadrit ligjor, 18 janë rekomandime të karakterit organizativ dhe 3 rekomandime të tjera, të cilat në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelën e mëposhtme:

**Tabela 5**

Nr.	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT				SIPAS Raportimit			
		Rekomandime të shprehura në numër				Rekomandime të shprehura në vlerë (shpërblim dem)			
		Gjithsej në numër	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar	Gjithsej në numër	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar
4	Viti 2024	25	5	8	12	0	0	0	0
<b>TOTALI</b>		<b>25</b>	<b>5</b>	<b>8</b>	<b>12</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

**Tabela nr.6:** Të dhënat e gjetjeve sipas fushave të auditimit dhe subjekteve të auditimit paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	SUBJEKTI AUDITUAR	GJETJET SIPAS FUSHËS OSE SISTEMEVE NE NUMER										
		Sistemi i prokurimeve, blerjeve & investimeve	Sistemi i pagesave, shpërblime, trajtime, komisione.	Fondet e sig. Shod, sig.shendetesore, përkuajdesje shoqërore	Sistemet e tatimeve, taksave, doganave	Sistemet e administrimit pronës, pasurisë	Sistemet e privatizimit, shitjes, qiradhënies	Sistemet e koncesioneve, ankandeve	Sistemet legalizimeve, urbanistikës, kthim pronash	Sistemet e kreditimit, subvencioneve	Të tjera	Audituesi mbuluar me auditim

1	Sektori i Financës									3	3
2	Sektori i Çështjeve Juridike dhe Prokurimeve	1									4
3	Sektori i Tatim-Taksave										3
4	Zbatim Rekomandimesh										15
	<b>Totali</b>	<b>1</b>									<b>25</b>

*Burimi Drejtoria e auditimit të Brendshëm Bashkia Fushë Arrëz*

Ndjekja e zbatimi i rekomandimeve për periudhën audituese është bërë sipas përcaktimeve të manualit të A.B. NJAB u ka dërguar Akt Verifikime për zbatimin e rekomandimeve të vitit 2024 me shkresa zyrtare të protokolluara tek zyra e Protokoll- Arkivit, po ashtu u janë dërguar edhe Raportet Finale njësisë të audituara për informim e zbatim mbi nivelin e zbatimit të tyre dhe në auditimin e radhës është çështja e zbatimit të rekomandimeve trajtohet si çështje kryesore.

**Tabela nr.7:** Rekomandimet sipas llojit dhe statusit të realizimit në subjektet e audituara.

Nr.	Subjekti Audituar	Rek. të dhëna në vitin 2024	STATUSI I REKOMANDIMEVE				REKOMANDIMET SIPAS LLOJIT				
			Rekomandim i dhënë	Rekomandim i pranuar	Rekomandim i zbatuar	Në proces zbatimi	Rekomandime të përmirësimit e sistemeve	Rekomandime të përmirësimit e kuadrit ligjor	Rekomandime të karakterit organizativ	Rekomandime për arkëtime	Rekomandime të tjera
1.	Sektori i Financës	3	3	3	1	1	1		2		
2	Sektori i Çështjeve Juridike dhe Prokurimeve	4	4	4	1	2		1	3		
3	Sektori i Tatim-Taksave	3	3	3	1	1			2		1
4	Zbatim Rekomandimesh	15	15	15	2	4		2	11		2
	<b>Totali</b>	<b>25</b>	<b>25</b>	<b>25</b>	<b>5</b>	<b>8</b>	<b>1</b>	<b>3</b>	<b>18</b>		<b>3</b>

*Burimi Drejtoria e auditimit të Brendshëm Bashkia Fushë Arrëz*

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve, rezulton se nga 25 masa të rekomanduara, janë pranuar 25 rekomandime, nga këto 5 rekomandim janë zbatuar, 8 rekomandime janë proces zbatimi, ndërsa rekomandime të pa zbatuara janë 12.

Nga auditimi rezulton se Drejtoria e Auditimit të Brendshëm ka marrë në shqyrtim dhe ka mbikëqyrur procesin e monitorimit e ndjekjes së rekomandimeve të dhëna nga struktura e auditimit të brendshëm. Grupi i auditimit nuk ka analizuar arsyet e mosrealizimit të rekomandimeve të mëparshme. Referuar Manualit të Auditimit të Brendshëm, Kapitulli IV, pika 4.1.13.3 përcaktohet se: “Një njësi e mirë menaxhuar vendos procedura për t’u siguruar se çdo rekomandim i bërë nga njësia e AB, zbatohet ashtu siç duhet. Njësia e Auditimit të Brendshëm në bashkëpunim me menaxhimin cakton një punonjës me përvojë që të evidentojë të gjitha rekomandimet e bëra nga auditimi i brendshëm dhe të komunikojë, monitorojë dhe informojë për progresin që është bërë për zbatimin e tyre. Kjo do të ndihmojë që të sigurohet se përmirësimi i kontroleve të brendshme është përgjegjësi e menaxhimit të njësisë publike dhe jo rol i Njësisë së Auditimit të Brendshëm”.

➤ **Vlerësimi i procedurave dhe standardeve të kryerjes së auditimit të brendshëm.**

*Nga auditimi i detajuar i dosjeve të auditimeve të kryera në subjektet:*

**Për vitin 2024** dosjet:

1. Sektori i Financës
2. Sektori i Çështjeve Juridike dhe Prokurimeve
3. Sektori i Tatim-Taksave
4. Zbatimi i rekomandimeve të dhëna

***Në lidhje me respektimin e kërkesave të manualit në hartimin e materialeve të auditimit për:***

a-Letrat e punës së auditimit në fazën përgatitore të programit;

b-Letrat e punës në fazën e ekzaminimit të dokumentacionit të subjektit, hartimit të Projekt Raportit dhe Raportit Final nga audituesit;

c- Bazueshmërinë ligjore të gjetjeve, argumentimin e konkluzioneve të nxjerra nga audituesit në përputhje me standardet e auditimit, rezultoi se:

-Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve të përzgjedhura në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe Manualit të Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016.

-Subjektet e audituara nuk kanë paraqitur Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve, në zbatim të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe Manualit të Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli IV, Pika 4.1.12. Hapi 11, “Raportet e auditimit dhe plotësimi i plan veprimit nga njësia e audituar”.

-Hartimi i Projekt Raporteve dhe Raporteve Përfundimtare në përgjithësi është bërë sipas strukturës së miratuar në manualin e auditimit.

Me shkresën nr.232.prot., datë 29.01.2025 është dërguar pranë Ministrisë së Financave informacioni vjetor të punës së sektorit të auditimit të brendshëm për vitin 2024.

Me shkresën nr.1141.prot., datë 18.04.2025 është dërguar pranë Ministrisë së Financave informacioni mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në Bashkinë Fushë Arrëz.

Programi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Njësinë e Auditimit të Brendshëm për vitin 2024 është hartuar dhe miratuar me urdhër nr. 253 datë 21.06.2024, por nuk është dërguar pranë Strukturës Përgjegjëse të Harmonizimit në MFE, në mospërputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli VII.

### **Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit në dispozicion u konstatua se:**

-Subjektet e audituara nuk kanë paraqitur Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve, në zbatim të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe Manualit të Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli IV, Pika 4.1.12. Hapi 11, “Raportet e auditimit dhe plotësimi i plan veprimit nga njësia e audituar”.

-Programi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Njësinë e Auditimit të Brendshëm për vitin 2024 është hartuar dhe miratuar me urdhër nr. 253 datë 21.06.2024, por nuk është dërguar pranë Strukturës Përgjegjëse të Harmonizimit në MFE, në kundërshtim me Ligjin Nr.114 datë 20.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, neni 12:

*Neni 12 përcakton përgjegjësitë e titullarëve si vijon: “Përgjegjësitë e titullarëve të njësive publike Titullarët e njësive publike janë përgjegjës për: a) sigurimin e shërbimit të auditimit të brendshëm, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij; c) miratimin me urdhër të Kartës së Auditimit; ç) miratimin e planit strategjik dhe vjetor të njësisë së auditimit të brendshëm; d) hartimin, miratimin dhe ndjekjen e planit të veprimit, për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të procedurave të auditimit nga njësia e auditimit të brendshëm dhe/ose në përfundim të procedurave të vlerësimit të cilësisë së auditimit nga struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit të raportit përfundimtar; dh) vënien në dispozicion të të gjithë informacionit dhe dokumenteve të nevojshme që audituesi kërkon për përmbushjen e angazhimit të auditimit; e) evidentimin e rasteve të parashikuara në shkronjat “b” dhe “c”, të pikës 1, të nenit 22, të këtij ligji, për të cilat informohet ministria përgjegjëse për financat”.*

*Për sa më sipër mban përgjegjësi*

*Z. H. C. Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz.*

*Znj. E. P. Drejtore e auditit të Brendshëm.*

## **Konkluzione:**

- Bashkia Fushë-Arrëz nuk ka një sistem të qartë për informimin e punonjësve mbi ligjet, rregulloret dhe etikën. Mungojnë procedurat për raportimin dhe trajtimin e shkeljeve etike, si dhe programet e trajnimit për integritet dhe menaxhim financiar.
- Bashkia Fushë-Arrëz nuk ka hartuar dhe miratuar një plan vjetor operacional për realizimin e objektivave strategjike dhe vjetore, duke munguar përcaktimi i veprimeve, afateve dhe përgjegjësve konkretë. Nuk ekziston një sistem funksional për menaxhimin dhe raportimin e risqeve, përfshirë riskun e mashtrimit, i cili nuk vlerësohet në mënyrë periodike dhe nuk është pjesë përbërëse e procesit të vlerësimit të riskut. Regjistri i risqeve nuk është protokolluar dhe mungon strategjia për menaxhimin e tyre. Titullari nuk ka ngritur grupin teknik koordinues dhe mungon raportimi i risqeve të menaxherët përkatës. Po ashtu, nuk ka plan-veprime për menaxhimin e riskut, dhe ndikimet nga riorganizimi strukturor nuk janë reflektuar në sistemin e kontrollit të brendshëm. Si pasojë, sistemi i kontrollit të brendshëm rezulton me efektivitet të ulët.
- Bashkia Fushë-Arrëz nuk ka procedura të qarta dhe të miratuara për ruajtjen, përdorimin dhe arkivimin e dokumentacionit. Mungojnë sisteme funksionale të TI-së jashtë atyre qeveritare (si APP, SIFQ, HRMIS etj.), si dhe nuk janë përcaktuar procedura për sigurinë e sistemit, mbrojtjen nga ndërhyrjet e paautorizuara dhe rikuperimin e të dhënave në rast fatkeqësish. Nuk ekziston ndarja e detyrave në sistemet TI për të shmangur përqendrimin e përgjegjësive në një individ. Bashkia nuk ka një sistem rezervë (back-up) funksional dhe të testuar, dhe nuk ka procedura të shkruara për rikuperim të të dhënave.
- Mungojnë gjithashtu procedura të shkruara për kontrollin e integritetit dhe sigurisë së të dhënave financiare, si rakordimet mujore të llogarive, aksesin në të dhëna kontabël dhe auditimin e veprimeve. Nuk ka procedura të veçanta për vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve publike. Menaxhimi i dokumentacionit të financës bëhet pa rregulla të brendshme specifike, vetëm në bazë të legjislacionit për arkivat.
- Bashkia Fushë-Arrëz nuk disponon një sistem të vet elektronik për mbajtjen e kontabilitetit, por përdor Excel, çka përbën risk për sigurinë, integritetin dhe ruajtjen e të dhënave financiare. Nuk ka procedura të përcaktuara për informimin e menaxherëve dhe punonjësve mbi vendimet apo nismat që ndikojnë në detyrat e tyre. Mungon komunikimi institucional i standardizuar, pasi jo të gjithë punonjësit posedojnë email zyrtar.
- Bashkia Fushë-Arrëz nuk ka një dokument të qartë dhe të mirëfilltë për ndjekjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, gjë që rrezikon uljen e performancës së tij. Mungojnë rregullat e brendshme të miratuara për menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe një plan veprimi zyrtar për këtë sistem. Personeli nuk përdor linjat e raportimit në kohë për të komunikuar çështjet e kontrollit të brendshëm të palët përkatëse. Nuk është ngritur një sistem efektiv monitorimi për të siguruar funksionimin dhe përditësimin e vazhdueshëm të menaxhimit financiar dhe kontrollit.
- Auditimi i kryer nga Njësia e Auditimit të Brendshëm ka qenë formal dhe jo analitik.
- -Subjektet e audituara nuk kanë paraqitur Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve, në zbatim të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe Manualit të Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli IV, Pika 4.1.12. Hapi 11, “Raportet e auditimit dhe plotësimi i plan veprimit nga njësia e audituar”.
- -Programi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Njësinë e Auditimit të Brendshëm për vitin 2024 është hartuar dhe miratuar me urdher nr. 253 datë 21.06.2024, por nuk është dërguar pranë Strukturës Përgjegjëse të Harmonizimit në MFE.

Për sa më sipër është mbajtur akt-konstatimi nr.1, datë 10.06.2025. Nuk ka observacione nga subjekti nën auditim në fazën e RPA-së.

***Pika 2. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2024 japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.***

Dokumentacioni i shqyrtuar:

1. Pasqyrat financiare të vitit 2024 të shoqëruar me formatet 1-9.
2. Dokumente kontabël si: ditarët e bankës, magazinës, pagave, të veprimeve të ndryshme, debitorëve, kreditorëve, furnitorëve, etj, centralizatori, bilanci vërtetues.
3. Dokumentacioni i kryerjes së inventarëve të aktiveve, libri i aktiveve.
4. Urdhër-shpenzimet dhe dokumentacioni bashkëlidhur.
6. Akt-rakordimet me Degën e Thesarit, në mbyllje të vitit buxhetor.
8. Të tjera dokumente mbështetëse (data bazë të ndryshme ne programet “Excel “si: për vendimet gjyqësore, për investimet, për ditarët, shpenzimet të ardhurat etj.).

***• Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:***

Për vitin 2024 nga njësia shpenzuese “Aparati i Bashkisë Fushë-Arrëz” për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr.5 datë 21.02.2022.

***• Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara.***

Bashkia Fushë Arrëz për vitin 2024 ka hartuar Pasqyrat Financiare të Konsoliduar, ndonëse nuk ka në varësi njësi shpenzuese me NIPT më vete.

***• Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare***

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga NA dhe NZ si dhe janë të dërguara në Degën e Thesarit Pukë për vitin ushtrimor 2024 me shkresë përcjellëse nr.878.prot., datë 25.03.2025. Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues është Kryetari i Bashkisë H. C. dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues është Përgjegjësi i Financës. Pra në këtë rast nuk kemi delegime të detyrave.

***• Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.***

Për vitin 2024 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

***• Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.***

Për tu siguruar nëse regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara për sa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;

- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditareve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

• ***Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit të Bashkisë***

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.

- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program Microsoft Office “Excel”.

- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.

- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, magazinës, të pagave etj. Është mbajtur centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në centralizator deri në bilancin vërtetues. Gjithashtu është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemimeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.

- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu: Dokumentet vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listë pagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

• ***Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.***

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomik - financiar për vitin 2024.

***Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim***

**Përkatësia:** Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

**Plotësia:** Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar,

**Saktësia:** Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme

**Periudha:** Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël, **Klasifikimi:** Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura.

**Ligjshmëria dhe rregullsia:** Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion.

***Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës***

**Ekzistenca:** Asetet, detyrimet dhe fondet e veta ekzistojnë.

**Të drejtat dhe detyrimet:** Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit.

**Plotësia:** Të gjitha asetet dhe fondet e veta janë regjistruar, dhe detyrimet janë regjistruar të gjitha në mbyllje të vitit ushtrimor, pra janë të paraqitura të plota në bilanc..

**Vlerësimi dhe alokimi:** Aktivet, pasivet dhe fondet e veta janë të përfshira në pasqyrat financiare me shumatat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, si dhe rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

*Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese*

**Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet:** Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

**Plotësia:** Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.

**Klasifikimi dhe kuptueshmëria:** Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe të përshekruara, si dhe janë mbajtur shënimet shpjeguese, të cilat shprehin paqartësitë e ndodhura.

**Saktësia dhe vlerësimi:** Informacioni financiar është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasinë e duhur.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Zyra e Financës dhe Buxhetit. Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2024 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2023.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2024 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjesë e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike;

Nga verifikimi i akt-rakordimit vjetor të thesarit për treguesit e realizimit të buxhetit dhe krahasuar këto me veprimet kontabël në llogarinë 520 “Disponibilitete në Thesar” dhe në ditarin e bankës rezultojnë të jenë rakorduara, veprime të paraqitura në formatin nr.5 “Pasqyrë e lëvizjes në cash viti 2024”. Totali i Aktivit për vitin 2024 është në vlerën 1,815,029,208 lekë dhe i paraqitur në formatin 1 e i zbërthyer në llogari sintetike dhe analitike, paraqitet si më poshtë:

Tabela nr.1: Aktiv i Bilancit 2024

Në lekë

Nr. Reshti	Referenca e Llogarive	EMERTIMI	Ushtrimi I Mbyllur	Ushtrimi Paraardhes
1	A	<b>A K T I V E T</b>	<b>1,815,029,208</b>	<b>1,734,333,986</b>
2		<b>I. Aktivet Afat shkurtër</b>	<b>478,826,552</b>	<b>448,762,028</b>
3		<b>1.Mjete monetare dhe ekuivalent te tyre</b>	<b>147,038,743</b>	<b>120,407,947</b>
4	531	Mjete monetare ne Arke		
5	512,56	Mjete monetare ne Banke		
6	520	Disponibilitete ne Thesar	147,038,743	120,407,947
7	50	Letra me vlere		
8	532	Vlera te tjera		
9	54	Akreditiva dhe paradhënie		
10	59	Provigjone zhvlerësimi letra me vlere (-)		
11		<b>2.Gjendje Inventari qarkullues</b>	<b>12,084,726</b>	<b>12,447,629</b>
12	31	Materiale		
13	32	Inventar I imët	10,636,984	10,636,984
14	33	Prodhim në proces		
15	34	Produkte		
16	35	Mallra	1,447,742	1,810,645
17	36	Kafshe ne rritje e majmëri		
18	37	Gjendje te pa mbërritura, ose pranë të tretëve		
19	38	Diferenca nga çmimet e magazinimit		
20	39	Provigjone për zhvlerësimin e inventarit (-)		
21		<b>3. Llogari te Arkëtueshme</b>	<b>319,703,083</b>	<b>315,906,452</b>
22	411	Klientë e llogari te ngjashme		
23	423,429	Personeli, paradhënie, deficite, gjoba		
24	431	Tatim e Taksa		
25	432	Tatime, mbledhur për llogari pushtetit lokal		
26	433	Fatkeqësi natyrore qe mbulohen nga shteti		

27	435	Sigurime Shoqërore		
28	436	Sigurime Shëndetësorë		
29	437,438,	Organizma te tjerë shtetërore		
30	44	Institucione te tjera publike		
31	465	Efekte për tu arkëtuar nga shitja e letrave me vlere		
32	468	Debitorë te ndryshëm	298,885,945	301,181,486
33	4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	20,817,138	14,724,966
34	45	Marrëdhënie midis institucioneve apo njësive ekonomike		
35	49	Shuma te parashikuara për zhvlerësim(-)		
36		<b>4.Te tjera aktive afatshkurtra</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
37	409	Parapagime		
38	473	Llogari e pritjes te marrëdhënieve me thesarin		
39	477	Diferenca konvertimi aktive		
40	481	Shpenzime për t'u shpërndare ne disa ushtrime		
41	486	Shpenzime te periudhave te ardhshme		
42		<b>II. Aktivet Afat gjata</b>	<b>1,336,202,656</b>	<b>1,285,571,958</b>
43	<b>20</b>	<b>1.Aktive Afatgjata jo materiale</b>	<b>14,406,521</b>	<b>12,216,078</b>
44	201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave		
45	202	Studime dhe kërkime	14,406,521	12,216,078
46	203	Koncesione, Patenta, Licenca e te ngjashme		
47	<b>21</b>	<b>2.Aktive Afatgjata materiale</b>	<b>1,115,595,892</b>	<b>1,151,255,880</b>
48	210	Toka, Troje, Terrene		
49	211	Pyje, Plantacione	5,088,456	5,088,456
50	212	Ndërtesa e Konstruksione	451,528,656	471,289,268
51	213	Rruge, rrjete, vepra ujore	620,250,284	639,099,014
52	214	Instalime teknike, makineri e pajisje	10,513,212	6,622,724
53	215	Mjete Transporti	6,649,390	8,311,738
54	216	Rezerva Shtetërore		
55	217	Kafshe pune e prodhimi		
56	218	Inventar ekonomik	21,565,894	20,844,680
57	24	Aktive afatgjata te dëmtuara		
58	28	Caktime te Aktiveve Afatgjata		

Burimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Fushë-Arrëz.

## A. AKTIVE AFATSHKURTRA

Në formatin nr. 1 “Aktivet Afatshkurtra” në aktiv të bilancit paraqiten në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 1,815,029,208 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,734,333,986 lekë.

-Klasa 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre” në mbyllje të vitit 2024 është në vlerën 147,038,743 lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën VI “ Teprica e likuiditeteve” në fund te vitit ushtrimor” në Formatin nr.3 “Pasqyra e flukseve monetare”(CASH-FLOË) sipas metodës direkte”.

-Gjendja e llogarisë 520 “Disponibilitete në Thesar”, sipas bilancit në mbyllje të vitit 2024, është në vlerën 147,038,743 lekë, gjendje e cila rakordon me realizimin në fakt të fondeve sipas akt-rakordimit me Degën e Thesarit, ku lëvizjet e këtyre disponibiliteteve paraqiten në formatin nr.5 “Pasqyrë e lëvizjes në cash viti 2024”.

-Në klasën 3 “Gjendja e inventarit qarkullues” të aktiveve qarkulluese paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 12,084,726 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 12,447,629 lekë, ku diferenca e tyre në ulje në vlerën prej -362,903 lekë rakordon me gjendjen e llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” në formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare”. Këto vlera në mënyrë analitike paraqiten në gjendjet e llogarive:

-Gjendja e llogarisë 32 “Inventari i imët” paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 10,636,984 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 10,636,984 lekë pa asnjë diferencë për vitin ushtrimor 2024.

-Klasa 4 “Llogari të arkëtueshme” paraqiten në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 319,703,083 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 315,906,452 lekë, ku kemi shtesë duke e krahasuar me vitin paraardhës, i cili ka ardhur si rezultat i rritjes se detyrimeve te debitorëve të ndryshëm

-Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, ku në mbyllje të vitit 2024 është në vlerën 298,885,945 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 është në vlerën 296,057,946 lekë. Vlera e debitorëve në vitin 2024 në krahasim me vitin 2023 ka pësuar një zbritje prej 2,295,541 lekë, e cila i përket debitorëve të likuiduar gjatë vitit 2024 nga taksat dhe tarifatat vendore. Në vlerën e lartë të gjendjes së llogarisë

së debitorëve ka ndikuar dhe gjendja e debitorëve të krijuar ndër vite nga mos përputhshmëritë e konstatuara nga auditimet e kryera nga KLSH, në vlerën 240,814,111 lekë dhe debitorët nga taksat dhe tarifatat vendore në vlerë progresive prej 51,884,950 lekë. Pjesa tjetër janë detyrime për kopshtin dhe çerdhen në shumën 48,500 lekë dhe detyrime të mbartura nga ish komunat në shumën prej 6,138,384 lekë. Analiza e gjendjes së llog.468 “Debitorë të ndryshëm” dhe lëvizjet e pësuar në vitin ushtrimor, krahasuar me vitin paraardhës paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Tabela 2/1:Lëvizja e llogarisë 468 për vitin 2024 /lekë

Lëvizja e llogarisë 468 Sintetike				Viti 2023		
Viti	Bashkia Fushë Arrëz dhe NJA	Përshkrimi	Gjendja 31.12.2023	Debi	Kredi	Mbetja
2024		Debitorë të ndryshëm	6,138,384	0	0	6,138,384

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit bashkia Fushë Arrëz

Në mënyrë të detajuar të dhënat për llogarinë 468 shtesat dhe pakësimet janë si më poshtë vijon:

Tabela 2/2 :Ndryshimet e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” gjatë vitit 2024 /lekë

Nr.	Përshkrimi	Vlera/lekë
1	Gjendje e debitorëve me 1.01.2024	48,495,543
2	Shtesa e debitorëve për taksat dhe tarifa e vitit 2024	5,123,540
3	Shtese debitorëve nga kontratat e qirave të ndryshme.	
4	Arkëtimet e debitorëve të bizneseve të viteve të mëparshme.	1,734,133
6=1+2+3-4	<b>Gjendja e debitorëve me 31.12.2024</b>	<b>51,884,950</b>

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, bashkia Fushë Arrëz

Tabela 2/3 :Ndryshimet e llogarisë 468 debitorë të Auditeve gjatë vitit 2024 /lekë

Nr.	Përshkrimi	Vlera/lekë
1	Gjendje e debitorëve me 1.01.2024	241,372,619
2	Shtesa e debitorëve për taksat dhe tarifa e vitit 2024	
3	Shtese debitorëve nga kontratat e qirave të ndryshme.	
4	Arkëtimet e debitorëve të bizneseve të viteve të mëparshme.	558,508
6=1+2+3-4	<b>Gjendja e debitorëve me 31.12.2024</b>	<b>240,814,111</b>

Tabela 2/4:Lëvizja e llogarisë 468 për vitin 2024 /lekë

Lëvizja e llogarisë 468 Sintetike				Viti 2023		
Viti	Bashkia Tropojë dhe NJA	Përshkrimi	Gjendja 31.12.2023	Debi	Kredi	Mbetja
2024		Debitorë të ndryshëm	51,400	48,500	51,400	48,500

Tabela nr.2/5: Analiza e gjendjes llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”

Në lekë

Nr	Emërtimi në zëra	Gjendje 31.12.2023	Sistemime (shtesa)	Shtuar gjatë vitit ushtrimor	Sistemime (pakësime)	Pakësuar gjatë vitit ushtrimor	Gjendje 31.12.2024
1	Debitorë në vite nga tatim taksat	48,495,543		5,123,540		1,734,133	51,884,950
2	Debitorë KLSH	241,372,619				558,508	240,814,111
3	Debitorë kopsht dhe çerdhe (Dhjetor 2024)	51,400		48,500		51,400	48,500
4	Debitorë nga ish Komunat	6,138,384					6,138,384
	<b>TOTALI llog 468</b>	<b>296,057,946</b>	<b>0</b>	<b>5,172,040</b>	<b>0</b>	<b>1,734,133</b>	<b>298,885,945</b>

Burimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Fushë-Arrëz.

Nga analiza e kësaj llogarie rezulton një shumë e konsiderueshme e akumuluar ndër vite. Kjo vlerë përbëhet nga debitorë nga tatimet dhe taksat në vlerën progresive 51,884,950 lekë; Debitorë nga mos përputhshmëritë e konstatuara nga auditimet e KLSH-së, në vite, në vlerën 240,814,111 lekë, debitorë për pagesat e kopshtit dhe çerdhes për muajin dhjetor 2024, të cilat janë likuiduar në muajin janar 2025 në vlerën 48,500 lekë, si dhe vlera prej 6,138,384 lekë që i përket debitorëve të transferuar nga Ish Komunat.

**Konstatim:** Gjatë vitit 2024, zëri i cili ka pësuar ndryshime pra shtesa dhe pakësime ka qenë debitorët në vite të tatim taksave, ku ka pasur shtesë të debitorëve me vlerën 5,123,540 lekë dhe pakësime me vlerën 1,734,133 lekë duke shtuar gjendjen e këtij zëri, nga 48,495,543 lekë në 31.12.2023 në vlerën 51,884,950 lekë në fund të vitit 2024. Zyra e Financës me shkresën nr.393, datë 10.02.2025 i është drejtuar zyrës Juridike që të ndërmerren masa ligjore për arkëtimin e kësaj shume, por kjo vlerë vazhdon të mbetet në rritje si rezultat i mos marrjes së masave shtrënguese në zbatim të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar si dhe ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreut XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të neneve 88 deri 104.

Deri në 31.12.2024, vlera progresive e debitorëve është **51,884,950** lekë, e përbërë nga:

- debitorë: tatimet dhe taksat në vlerën 23,476,511 lekë;
- Debitorë institucione publikë në vlerën 2,097,926 lekë;
- Debitorë për kontrata qiraje në vlerën 26,310,513 lekë.

Rezulton se sektori i taksave, dhe tarifave vendore në Bashkia Fushë Arrëz nuk ka llogaritur penalitete (kamatëvonesë), për mos likuidim në afat të detyrimeve si dhe nuk ka ndërmarrë asnjë procedurë për bllokimin e llogarive bankare. në kundërshtim me Kreun XI-Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni nenet 15 dhe 181 -Mospagimi i taksave dhe tatimeve, apo të parashikimit të vendimeve (vlerave) të gjobave të përcaktuara në nenin 46 të ligjit “Për Kundërvajtjet Administrative” (brenda 2 viteve), ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 -Mospagimi i taksave dhe tatimeve, me pikat 3,4, 5 dhe 5, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar.

- Gjendja e llogarisë 4342 “Të tjera operatione me shtetin (të drejta)” në aktiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në shumën 20,817,138 lekë, e cila përfaqëson detyrimet afatshkurtra për muajin dhjetor 2024, që trashëgohen në vitin 2025. Kjo gjendje ka në analizë ose përfshin gjendjet e llogarive në pasivin e bilancit:

*llog.401-404 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”* në vlerën 310,313 lekë,

*llog.42 “Detyrime ndaj personelit”* për vlerën 14,622,874 lekë,

*llog.431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”* për vlerën 949,397 lekë,

*llog.435 “Sigurime shoqërore”* për vlerën 4,345,648 lekë,

*llog.436 “Sigurime shëndetësore”* për vlerën 588,906 lekë, të planifikuara për likuidim në vitin 2025.

Gjendja e *llog.4342 “Të tjera operatione me shtetin (të drejta)”* pasqyron detyrimet afatshkurtra, duke u debituar në kredi të llogarive kundër parti në pasiv të Bilancit, pasi kjo llogari përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për mbulimin me fonde në vitin pasardhës të shpenzimeve të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara.

## **II. Auditimi i Aktiveve Afatgjata materiale**

*Objektivat e auditimit të aktiveve afatgjata materiale*, janë që të sigurohemi se:

Aktivitet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.

### **2. Kontrolle të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:**

- Për auditimin e aktiveve afatgjata materiale, u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme si:
- U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve afatgjata materiale në raport me gjendjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;
- U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhur ndonjë variacion anormal mbi aktivet afatgjata materiale;

- U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;
- U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuar dhe udhëzimeve përkatëse.
- U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;
- U krahasuan investimet e realizuara gjate ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet.

### 3. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve afatgjata materiale:

a. Gjatë hyrjes së aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se veprimet janë kryer në zbatim të kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Për Aktivet e blera janë kryer teste për 4 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabël nëse janë kontabilizuar sipas vlerës së tyre të marrjes (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);
- Për Aktivet e marra falas janë kryer teste për 3 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabël nëse janë kontabilizuar duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;
- Aktivet e sjella në subjekt (kalim kapital) janë kryer teste për 2 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabël nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes.

b. Për inventarin, janë kryer teste për tu siguruar që subjekti:

- Procedon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve të saj të qëndrueshme sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranuar;
- Përdor referencat ose teknikat më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifike, etj.);
- Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.

Në formatin nr. 1 “Aktivet Afatgjata” në aktiv të bilancit paraqiten në vlerën neto në mbyllje të vitit 2024 në vlerën **1,336,202,656 lekë** dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën **1,285,571,958 lekë**, ku diferenca përfaqëson vlerën e amortizimit të llogaritur. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,579,982,844 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 1,605,901,224 lekë të cilat janë të pasqyruara më poshtë sipas llogarive analitike.

### Klasa 20 “Aktive Afatgjata jo materiale” që përbëhet nga:

*Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”* në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën 20,191,432 lekë, ndërsa në fund të vitit 2024 rezulton në vlerën 24,214,287 lekë. Kjo shumë rakordon me inventarin sipas kartelave të personave që kanë në ngarkim.

*Llogaria 202 “Studime e Projektme”* në pasqyrat e pozicionit financiar gjendet në vlerën 14,406,521 lekë, vlerë e cila shpreh gjendjen e mbetur progresive duke zbritur dhe amortizimin sipas normave ndër vite.

Tabela nr.3: Inventari i llogarisë 202 "Studime dhe kërkime "

Në lekë

Nr.	Emërtimi	Çelja 01.01.2024	Shtesa	Pakësime	Gjendja 31.12.2024
1	Projekt studim pjesore I Qytetit Fushe Arrëz	390,000			390,000
2	Projekt I rikonstruksionit te ujesjellësit Micoj, Kaptazhi + Linja Kryesore	165,000			165,000
3	Sistemim asfaltim rruga Mzi Njësia Administrative Fierze	2,845,620			2,845,620
4	Sistemim asfaltim rruga Gjinaj Njësia Administrative Q-Mali	412,562			412,562
5	Sistemim asfaltim rruga Nushaj Fushe Arrëz	335,502			335,502
6	Shndërrimi I godinës se tregut per Bashkinë e re	1,184,054			1,184,054
7	Ndërtim I markatës se re të qytetit Fushe Arrëz	312,452			312,452
8	Rikonstruksion I fasadave ne rrugën Rinia	1,364,862			1,364,862
9	Rikonstruksion I kanalit ujitës Micoj, Dedaj, Marinaj	1,108,280			1,108,280
10	Njësia Qafe Mali	1,597,100			1,597,100
11	Njësia Fierze	1,098,000			1,098,000
12	Njësia Iballë	1,448,800			1,448,800
13	Njësia Blerim	360,000			360,000
14	Projektim i objektit Sistemim asfaltim ndriçim dhe rikualifikim I hapësirave te gjelbra ne rrugën Rinia qytet Fushe Arrëz	560,000			560,000

15	Projektim I objektit Ndërtim I rrjetit te plote te ujësjellësit te ri ne Fshatin Kryezi	3,588,000			3,588,000
16	Projektim I objektit sistemim rrethim gjelbërim I varrezave publike ne Qytetin Fushe Arrëz	350,000			350,000
17	Projekt për Shkollën 9-vjeçare Blerim	745,000			745,000
18	Projekt për hapje rruge auto rurale Fshat Apripe Guri, Njësia Fierze	1,827,000			1,827,000
19	Projekte teknike te kalldajave	499,200			499,200
20	Plan Menaxhimi pyjore Kryezi		4,022,855		4,022,855
	<b>Totali</b>	<b>20,191,432</b>	<b>4,022,855</b>		<b>24,214,287</b>

Burimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Fushë-Arrëz.

Ndryshime në këtë llogari paraqiten sipas tabelës së mëposhtme:

Objekti	Shtesa	Pakësimi
Plan Menaxhimi pyjore Kryezi	4,022,855	
<b>Totali:</b>	<b>4,022,855</b>	

Burimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Fushë-Arrëz.

U zhvilluan teste kontrolli dhe teste të detajeve të **posteve Aktiveve materiale të llogarive sintetike dhe analitike të bilancit kontabël** për vitet 2023 dhe 2024.

Në formatin nr.1 (Aktiv i bilancit) “Aktivet afatgjata materiale” paraqiten me vlerë neto në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 1,115,595,892 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në shumën totale prej 1,151,255,880 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 1,559,791,412 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023, në vlerën 1,115,595,892 lekë. Kjo llogari sintetike e analizuar paraqitet në llogaritë e mëposhtme:

- **Gjendja e llogarisë 211 “Pyje, Plantacione”** paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2024 në shumën prej 5,088,456 lekë si dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 5,088,456 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 5,948,353 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerë të njëjtë prej 5,948,353 lekë.

Tabela nr.4: Gjendja e llogarisë 211 “Pyje, Plantacione”

Nr.	Emërtimi	Çelja 01.01.2024	Shtesa	Pakësim	Gjendja 31.12.2024
1	Pyllëzim me arre dhe gështenjë	2,083,440			2,083,440
2	Njësia Qafe Mali	1,767,047			1,767,047
3	Njësia Fierze	0			0
4	Njësia Iballe	454,800			454,800
5	Njësia Blerim	1,235,412			1,235,412
6	Pyllëzime me drurë frutor Fierze	407,654			407,654
	<b>Totali</b>	<b>5,948,353</b>			<b>5,948,353</b>

Burimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Fushë-Arrëz.

-**Gjendja e llogarisë 212 “Ndërtesa Konstruksione”** paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 451,528,656 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 471,289,268 lekë, ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 657,150,334 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 659,552,334 lekë. Gjatë vitit 2024 janë pakësuar aktive për shkak te amortizimit ne vlerën 22,162,612 lekë dhe janë shtuar aktive ne vlerën 2,402,000 lekë. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie dhe ndryshimet për vitin 2024, të pasqyruar në tabelën nr.1, në anekse bashkëlidhur këtij raporti.

Shtesat në këtë llogari janë paraqitur në mënyre tabelare si më poshtë:

Objekti	Shtesa
Rikonstruksion nyje sanitare te Godina e Administrimit Pyjore dhe Mbrojtjes nga zjarri	468 000
Riparim banjash shkolla Arst Miliska, Porav dhe Apripe Guri	830000
Rikonstruksion çatie shkolla 9-vjeçare Dardhe	1104000
<b>Totali:</b>	<b>2,402,000</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i Klsh-së.

- **Gjendja e llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”** paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 620,250,284 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 639,099,014 lekë. Gjendja

me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 4,592,327,159 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 833,044,761 lekë. Gjatë vitit 2024 janë bërë shtesat në vlerën 846,150,982 lekë, pasqyruar në tabelën nr.2, në anekse bashkëlidhur këtij raporti.

Shtesat në këtë llogari janë paraqitur në mënyre tabelore si më poshtë:

Objekti	Vlera
Rikonstruksion rruga Fërroj	838,800
Riparim muri mbajtës ne rrugën Micoj	417,600
Riparim muri mbajtës ne unazen poshte te qytetit	580,800
Rikonstruksion ura këmbësore Fshat Berishe Vendi, Shopel, Mertur, Levoshe	940,000
Ndërtim ure këmbësore ne fshatin Aprripe Guri	422,000
Ndërtim ura këmbësore ne fshatrat Blerm, Truen i poshtëm	773,736
Ndërtim ure auto lagje Breg Lumi, Fashti Iballe	1,765,128
Rikonstruksion vija Gojans	874,800
Rikonstruksion vija Shpoz	952,800
Rikonstruksion vija vaditëse e lagjes Mejdan	2,727,600
Rikonstruksion vije vaditëse fshati Fierze (vada e Bobit)	2,198,610
Blerje tub korregate	614,347
<b>Totali:</b>	<b>13,106,221</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i Klsh-së.

- Gjendja e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerë neto paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 6,622,724 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 10,513,212 lekë. Ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 11,168,888 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 15,408,456 lekë ku është shtuar gjatë vitit 2024 për shkak të amortizimit 4,094,546 lekë dhe është shtuar në vlerën 4,239,568 lekë. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie paraqitet si më poshtë.

Tabela nr.5: Inventari kontabël i llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune “me datë 31.12.2024

Nr.	Emërtimi i aktiveve Llogaria 214	Gjendja me 01.01.2024	Shtesa gjatë 2024	Pakësime gjate 2024	Gjendja me 31.12.2024
1	Kazan metalik mbeturinash	168,000			24,000
2	Kazana rrugor metalik tek	24,000			7,800
3	Kosha rrugor metalik qift	7,800			804,000
4	Kazana mbeturinash	804,000			224,000
5	Njësia Qafe Mali	224,000			572,500
6	Njësia Fierze	572,500			188,900
7	Njësia Iballe	188,900			0
8	Njësia Blerim	0			1,171,200
9	Kosha mbeturinash	1,171,200			2,438,688
10	Vendosje kamera sigurie në ambiente publike dhe Institucione në varësi të Bashkisë Fushë Arrëz R.shpk .UB 6180	2,438,688			1,402,800
11	Veshje dhe pajisje për zjarrfikësit 14	1,402,800			1,758,000
12	Fadrome (ruge rurale)	1,758,000			2,038,200
13	Makine teknologjike	2,038,200			180,000
14	Motosharre	180,000			36,000
15	Shkalle metalike me 3 hapje	36,000			48,000
16	Aparat gur fleksibël profesional Deçolt	48,000			57,600
17	STIHLBR 600 238mph677 CFM Gas Backpack Leaf Bloë	57,600			49,200
18	Aparat Ap 3	49,200			24,000
19	Kosha mbetjesh urbane		720,000		720,000
20	Sistem me kamera për unazën sipër dhe poshtë te qytetit		932,820		932,820
21	Dron me telekomande RC-N Kamera CMQS 4/3		158,568		158,568
22	Blerje projektor per ndriçimi		1,064,940		1,064,940
23	Blerje kontejnerë per shkollën Mertur		730,440		730,440
24	Perse ligustrash me benzin (perdorim profesional) gjatesia e tehut preses 60 cm		32,000		32,000
25	Korrse bari me benzin komfort, gjeresia prerse 46 cm, 7 nivele lartesisie, kosh me volum 55 l, timon i palosshem, 139cm3, 2.1 kë, 2.8 hp, 26 kg		42,000		42,000
26	Motokosa Profesionale (Sharr Pastrimi) FS-260 C-E, 41.6 cm3, 2.0/2. 7 kë/hp, 8.5 kg, 168 cm		86,000		86,000
27	Sinjalistike për turizimin		472,800		472,800
	<b>Totali</b>	<b>11,168,888</b>	<b>4,239,568</b>		<b>15,408,456</b>

Burimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Fushë-Arrëz.

Shtesat në këtë llogari janë paraqitur në mënyre tabelore si më poshtë:

Objekti	Vlera
Kosha mbetjesh urbane	720,000
Sistem me kamera për unazën sipër dhe poshtë të qytetit	932,820
Dron me telekomande RC-N Kamera CMQS 4/3	158,568
Blerje projektor për ndriçim	1,064,940
Blerje kontejnerë për shkollën Mertur	730,440
Prerës ligustrash me benzinë (përdorim profesional) gjatësia e tehut prerës 60 cm	32,000
Korrëse bari me benzinë komfort, gjerësia prerëse 46 cm, 7 nivele lartësie, kosh me volum 55 l, timon i palosshëm, 139cm3, 2.1 kë, 2.8 hp, 26 kg	42,000
Motokosa Profesionale (Sharr Pastrimi) FS-260 C-E, 41.6 cm3, 2.0/2. 7 kë/hp, 8.5 kg, 168 cm	86,000
Sinjalistikë për turizmin	472,800
<b>Totali:</b>	<b>4,239,568</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i Klsh-së.

- Gjendja e llogarisë 215 “Mjete Transporti” në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 6,649,390 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 8,311,738 lekë, ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet si në mbyllje të vitit 2024 dhe në mbyllje të vitit 2023 është po ashtu në vlerën 19,250,835 lekë, gjë që tregon se nuk ka shtesa dhe pakësime gjatë vitit 2024.

Tabela nr.6: Inventari kontabël i llogarisë 215 "Mjete transporti "me datë 31.12.2023, 31.12.2024

Nr	Emërtimi i aktiveve Llogaria 215	Gjendja me 01.01.2024	Shtesa gjatë 2024	Pakësime gjate 2024	Gjendja me 31.12.2024
1	Njësia Qafe Mali	980,000			980,000
2	Njësia Fierze	1,577,000			1,577,000
3	Njësia Iballe	1,167,285			1,167,285
4	Njësia Blerim	1,191,475			1,191,475
5	Njësia Blerim	3,525			3,525
6	Zjarrfikëse Mercedes Benz 2000 litërshe	3,999,990			3,999,990
7	Fuoristrade Range Rover	2,520,000			2,520,000
8	Fouristrade Nisan	960,000			960,000
9	Blerje Kamioni O. shpk, UB6180	2,988,000			2,988,000
10	Autobot uji për shërbimin zjarrfikës	3,863,560			3,863,560
	<b>Totali</b>	<b>19,250,835</b>			<b>19,250,835</b>

Burimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Fushë-Arrëz

- Gjendja e llogarisë 218 në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 21,565,894 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 20,844,680 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 33,228,241 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 35,375,977 lekë. Kjo llogari ka pësuar rritje në vlerën 2,147,736 lekë përgjatë vitit 2024, përkatësisht këto janë shtesa pa pagesë gjatë vitit 2024, pajisje zyre (karrige dhe tavolina) të cilat i janë dhuruar nga ZVA Pukë, Shkollës Fushë Arrëz me dokument shoqërues, Shkresa nr. 267/3, datë 08.10.2024 si dhe Fletë dalje nr. 9, datë 8.10.2024. Gjithashtu janë dhe pajisje të dhuruara nga Projekti Bashki të forta për sallën e Këshillit të Bashkisë sipas Proces verbalit datë 3/8/2023.

Kjo rritje pasqyrohet në mënyre tabelore si më poshtë:

Tabela nr.7: Pajisje të dhuruara nga Projekti Bashki të forta për sallën e Këshillit të Bashkisë

Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
Printer komercial profesional Rioch MPC3004	Cope	2	165360	<b>330,720</b>
Kompjuter set Ram 16GB, I7, SSD 128 gb, Monitor 23.8 inch	Cope	2	101400	<b>202,800</b>
Kompjuter set Ram 8GB, I7, SSD 128 gb, Monitor 23.8 inch	Cope	1	78096	<b>78,096</b>
Koka kabulli cat 6	Cope	50	36	<b>1,800</b>
Sëitch me 5 porta gigabit	Cope	15	10440	<b>156,600</b>
Kabull rrjeti cat 6	ML	300	132	<b>39,600</b>
Kondicioner	cope	1	303732	<b>303,732</b>
Tavolina	cope	10	12780	<b>127,800</b>
Karrige rrotulluese me koke metalike	cope	18	5880	<b>105,840</b>
Atem Mini	cope	1	72216	<b>72,216</b>
4K Handy cam	cope	2	148680	<b>297,360</b>
Tv 65"	cope	1	92040	<b>92,040</b>
Tripod	cope	1	9204	<b>9,204</b>

UPS	cope	1	32568	<b>32,568</b>
Lap top i7 16gb ram	cope	1	99120	<b>99,120</b>
Microphone delegate	cope	3	32568	<b>97,704</b>
Microphone chairman	cope	1	36816	<b>36,816</b>
Audio mixer	cope	1	63720	<b>63,720</b>
<b>Totali:</b>				<b>2,147,736</b>

Burimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Fushë-Arrëz

- Gjendja e aktiveve afatgjata në vlerën bruto dhe neto si dhe ndryshimet për vitin 2024 paraqiten në Formatin nr.7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” të PF si më poshtë:

Tabela nr.8: Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata

Nr.	EMERTIMI	Teprica ne fillim			Shtesat gjate vitit		Pakësimet gjate vitit		Teprica ne Fund		
		Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historik	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
b	C	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
20	I. AAGJ/JO MATERIALE	20,191,432	7,975,354	12,216,078	4,022,855	1,832,412	0	0	24,214,287	9,807,766	14,406,521
202	Studime dhe kërkime	20,191,432	7,975,354	12,216,078	4,022,855	1,832,412			24,214,287	9,807,766	14,406,521
21-	II. AAGJ/ MATERIALE	1,559,791,412	408,535,532	1,151,255,880	21,895,525	57,555,513	0	0	1,581,686,937	466,091,045	1,115,595,892
210	Toka, troje, Terrene			0					0	0	0
211	Pyje, Kullota Plantacion	5,948,353	0	5,948,353					5,948,353	0	5,948,353
212	Ndërtime e Konstruksion	657,150,334	186,720,963	470,429,371	2,402,000	22,162,612			659,552,334	208,883,575	450,668,759
213	Rruge, rrjete, veptra ujqor	833,044,761	193,945,747	639,099,014	13,106,221	31,954,951			846,150,982	225,900,698	620,250,284
214	In. Tekn ,makineri pajisje vegla pune	11,168,888	4,546,164	6,622,724	4,239,568	349,080			15,408,456	4,895,244	10,513,212
215	Mjete transporti	19,250,835	10,939,097	8,311,738		1,662,348			19,250,835	12,601,445	6,649,390
216	Rezerva shtetërore	0	0	0					0	0	0
217	Kafshe pune e prodhimi	0	0	0					0	0	0
218	Inventar ekonomik	33,228,241	12,383,561	20,844,680	2,147,736	1,426,522			35,375,977	13,810,083	21,565,894
24	A.Q.T te dëmtuara	0		0					0	0	0
28	Caktime	0		0					0	0	0
	<b>TOTALI (I+II)</b>	<b>1,579,982,844</b>	<b>416,510,886</b>	<b>1,163,471,958</b>	<b>25,918,380</b>	<b>59,387,925</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>1,605,901,224</b>	<b>475,898,811</b>	<b>1,130,002,413</b>

Burimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Fushë-Arrëz

- Amortizimi i AQ materiale dhe jo materiale paraqitet në bilanc në vlerën 475,898,811 lekë, e cila kuadron me pasqyrën e amortizimit të bilancit në formatin nr. 7, kolona 9.

#### • Inventarizimi i aktiveve

Në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore për kryerjen e procedurave të inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe qarkulluese rezultoi se:

Në bazë të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” është kryer procesi i inventarizimit të aktiveve për vitin 2023 dhe 2024 për Bashkinë Fushë Arrëz dhe Njësite Administrative në varësi.

Për kryerjen e procesit të inventarizimit për vitin 2023 ka dalë urdhri i titullarit me nr. 577.prot., datë 30.11.2023 “Për ngritjen e komisionit për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata dhe inventarit në përdorim për vitin 2023”. Në bazë të këtij urdhri janë përcaktuar komisionet e inventarizimit sipas objekteve ku do kryhet inventarizimi. Nga auditimi i dokumentacionit të

mbajtur për kryerjen e inventarizimit rezultoi se, komisionet e inventarizimit kanë hartuar fletët e inventarëve me gjendjen fizike të aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara e të trupëzuara dhe gjendjen kontabël sipas llogarive si për Aparatin e Bashkisë dhe për njësitë në varësi si Njësitë Administrative, shkollat, kopshtet dhe çerdhet (qytet dhe fshat), Qendra Kulturore e Fëmijëve. Fletët e inventarëve janë të konfirmuara nga komisioni dhe përgjegjësit material brenda muajit dhjetor 2023 dhe rezultojnë pa diferenca. Për kryerjen e procesit të inventarizimit për vitin 2024 ka dalë urdhri i titullarit nr. 169, datë 08.04.2025 “Për ngritjen e komisionit për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata dhe inventarit në përdorim për vitin 2024”. Në bazë të këtij urdhri janë përcaktuar komisionet e inventarizimit sipas objekteve ku do kryhet inventarizimi.

**Konkluzion:** Gjendja e llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” në mbyllje të vitit ushtrimor 2024 paraqitet në vlerën 122,100,000 lekë, ku sipas analizës rezulton që kjo llogari nuk ka pësuar ndryshime dhe ka të bëjë me aksionet e Ndërmarrjes së Ujësjellës Kanalizime. Këto aksione janë transferuar nga ndërmarrja ekzistuese në Shoqërinë Rajonale e Ujësjellës Kanalizime Shkodër.

Bashkia Fushë Arrëz me shkresën nr. 392, datë 10.02.2025 ka kërkuar nga kjo Shoqëri vlerën e aksioneve të veta që kjo shoqëri ka në mbyllje të vitit 2024, por nuk ka marrë përgjigje. Megjithatë rezulton se në këtë llogari nuk është pasqyruar transferimi i kësaj shoqërie tek shoqëria e krijuar rishtazi. Aksionet e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër janë 38,680 x 100 = 38,680,000 lekë. Bashkia Fushë Arrëz zotëron 0.86% të këtyre aksioneve ose 332,648 lekë.

- Gjendja e llogarisë 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” në mbyllje të vitit ushtrimor 2024 paraqitet në vlerën 84,100,243 lekë, ku sipas analizës rezulton që kjo llogari paraqet vlerën pjesore të paguar të kontratave të investimeve që janë në vazhdim të pa kapitalizuar.

Tabela nr.9: Gjendja e llogarisë. 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT”

	<b>Llogaria 231 VITI 2023 gjendje 31.12.2024</b>	<i>DEBI</i>
<b>Nr.</b>	<b>Emërtimi</b>	231
1	Rikonstruksion I kopshtit te fëmijëve Fushe Arrëz, Bashkia Fushe Arrëz	33,725,225
2	Rehabilitim i digës se rezervuarit Iballe	50,375,018
	<b>Totali</b>	<b>84,100,243</b>

Burimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Fushë-Arrëz

Tabela nr.10: Analiza e Llogarive të Pasivit të Bilancit Kontabël: në lekë

<b>Nr.</b>	<b>Referenca e Llogarive</b>	<b>E M E R T I M I</b>	<b>Ushtrimi i Mbyllur 2024</b>	<b>Ushtrimi Paraardhës 2023</b>
<b>65</b>	<b>B</b>	<b>PASIVET(DETYRIMET)</b>	<b>331,325,219</b>	<b>325,100,768</b>
66		<b>I. Pasivet Afat shkurtra</b>	<b>331,325,219</b>	<b>325,100,768</b>
67		<b>1. Llogari te Pagueshme</b>	<b>32,439,274</b>	<b>23,919,282</b>
68	401-408	Furnitorë e llogari te lidhura me to	310,313	349,662
69	42	Detyrime ndaj personelit	14,622,874	10,642,438
70	16,17,18	Hua Afat shkurtra		
71	460	Huadhënës		
72	431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	949,397	389,191
73	432	Tatime, mbledhur për llogari pushtetit lokal		
74	433	Detyrime, shteti fatkeqësi natyrore		
75	435	Sigurime Shoqërore	4,345,648	2,936,714
76	436	Sigurime Shëndetësore	588,906	406,961
77	437,438,	Organizma te tjerë shtetërore		
78	44	Institucione te tjera publike		
79	45	Marrëdhënie midis institucioneve apo njësive ekonomike		
80	464	Det. për tu paguar për blerjen e .letrave me vlere		
81	466	Kreditore për mjete ne ruajtje	11,622,136	9,194,316
82	467	Kreditore te ndryshëm		
83	4341	Operacione me shtetin( detyrime)		
84	49	Shuma te parashikuara për zhvlerësim(-)		
85		<b>2.Te tjera pasive afatshkurtra</b>	<b>298,885,945</b>	<b>301,181,486</b>
86	419	Kreditore, Parapagime		
87	470	Llogari ne pritje - Te ardhura për tu marre	298,885,945	301,181,486
88	478	Diferenca konvertimi pasive		
89	480	Te ardhura për tu klasifikuar ose rregulluar		
90	487	Te ardhura te arkëtuara para nxjerrjes se titullit		
91		<b>II. Pasivet Afat Gjata</b>		
92	Klase 4	Llogari te pagueshme	<b>0</b>	<b>0</b>
93	16.17,18	Huatë Afat gjata		
94		Provigjionet afatgjata		
95	Klasa 4	Te tjera		
96	<b>C</b>	<b>AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)</b>	<b>1,483,703,989</b>	<b>1,409,233,218</b>
97	<b>D</b>	<b>FONDI I KONSOLIDUAR :</b>	<b>1,483,703,989</b>	<b>1,409,233,218</b>
98	101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	1,142,087,139	1,175,919,587
99	12	Rezultatet e mbartura		
100	85	Rezultati I Veprimtarisë Ushtrimore	135,416,607	111,213,631
101	111	Rezerva		
102	115	Nga Fondet e veta te investimeve		
	15	Shuma te parashikuara për rreziqe e Zhvlerësime		
103	105	Teprica e Grandeve kapitale Te Brendshme	206,200,243	122,100,000
104	106	Teprica e grandeve kapitale Te Huaja		
105	107	Vlera e mjeteve te caktuara ne përdorim		
106	109	Rezerva nga Rivlerësimi I Aktiveve Afatgjata		
107		Te Tjera		
108	<b>E</b>	<b>TOTALI I PASIVEVE(B+C)</b>	<b>1,815,029,208</b>	<b>1,734,333,986</b>

Pasivët afatshkurtra. Sipas pasqyrave financiare gjendja e llogarive kreditore në total paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 1,815,029,208 lekë dhe përbëhet nga llogaritë si vijon:

- *Gjendja e llogarisë 401- 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”* përfaqëson detyrimet ndaj të tretëve për fatura të pa likuiduara. Gjendja e kësaj llogarie në pasiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 310,313 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 349,662 lekë. Kjo llogari ka detyrime ndaj të tretëve të muajit dhjetor 2024 të cilat likuidohen në vitin pasardhës, që pasqyrohen në detaje në tabelën më poshtë:

Tabela nr.11: Analiza e gjendjes së llog.401- 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”

Nr.	Operatori ekonomik	Shuma Në lekë
1	Energji elektrike (FSHU)	267,451
2	Ujësjiellës sha	34,752
3	Poste	8,110
<b>Totali:</b>		<b>310,313</b>

Burimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Fushë-Arrëz

**a.** Pagesë për FSHU për muajin Dhjetor 2024 për vlerën 267,451 lekë.

**b.** Pagesë për Ujësjiellës Sha detyrim i muajit Dhjetor 2024 për vlerën 34,752 lekë.

**c.** Pagesë për shërbime postare për muajin dhjetor 2024 në shumën prej 8,110 lekë sipas faturës nr. 2288, date 7.1.2025, Këto janë fatura të muajit Dhjetor 2024 të cilat janë likuiduar në Janar të vitit 2025.

- *Gjendja e llogarisë 42 “Detyrime ndaj personelit”* paraqitet në fund të vitit 2024 në vlerën 14,622,874 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë pagesave të punonjësve të muajit Dhjetor 2024 për pagat që do të paguhen në Janar të vitit 2025.

- *Gjendja e llogarisë 431 “Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat* paraqitet në fund të vitit 2024 në vlerën kontabël 949,397 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë-pagesave të punonjësve të muajit Dhjetor 2024 për detyrimet tatimit mbi pagën, që do të paguhen në janar të vitit 2025.

- *Gjendja e llogarisë 435 “Sigurime shoqërore* paraqitet në fund të vitit 2024 në vlerën 4,345,648 lekë, të llogaritura për tu paguar në muajin pasardhës.

- *Gjendja e llogarisë 436 “Sigurime shëndetësore”* në fund të vitit 2024 është në vlerën kontabël 588,906 lekë.

- Gjendja e llogarisë 466 “*Kreditorë për mjete në ruajtje*” përfshin garancitë e ngurtësuar për investime të kryera. Gjendja e kësaj llogarie paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 11,622,136 lekë. Analiza e llogarisë 466 “*Kreditorë për mjete në ruajtje*”, aneksi nr.1.

**Konstatim:** Për këtë gjendje të llogarisë 466 “*Kreditorë për mjete në ruajtje*” është bërë rakordimi në degën e Thesarit Pukë.

Pavarësisht sa më sipër, nga analizimi i kësaj llogarie vlera në fund të vitit 2024 mbetet në vlera të larta dhe ka të akumuluar si shumë nga viti 2014 e në vazhdim. Zyra e financës i është drejtuar me shkresën nr. 389, port, datë 10.2.2025, Zyrës së Menaxhim Territorit dhe Investimeve që të kontaktohen të gjithë subjektet përfituese në mënyrë që të paraqesin dokumentacionin për likuidimin e kësaj shume, pasi janë plotësuar afatet kontraktuale për likuidimin e vlerës së garancisë, nga ditari i marrëdhënieve me thesarin shuma e likuiduar në vlerën 2,100,432 lekë. Kjo shumë është e pa konsiderueshme në raport me gjendjen e akumuluar të kësaj llogarie.

- Gjendja e llogarisë 470 “*Llogari në pritje- të ardhura për tu marrë*” në mbyllje të vitit 2024 është në vlerën 298,885,945 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 paraqitet në vlerën 301,181,486 lekë me një diferencë në rritje prej 2,295,541 lekë. Ulja e kësaj vlere tregon dhe uljen e debitorëve të ndryshëm.

Tabela nr.12:Analiza e llogarisë 470 “Llogari në pritje- të ardhura për tu marrë”

Akt kontrolle	Kopshte, Çerdhe	Ish-komunat	tatim taksa	Viti
<b>470</b>	<b>470</b>	<b>470</b>	<b>470</b>	Totali
240,814,111	27,300	6,138,384	5,123,540	2024
	21,200		2,816,857	2023



Gjendja e llogarisë sintetike 70 “Të ardhurat nga taksat dhe tatimet” paraqitet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 17,681,815 lekë, i cili kuadron me Akt rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

-Gjendja e llogarisë analitike 7002 “*Tatim mbi biznesin e vogël*” pasqyrohet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 124,056 lekë e cila e cila rakordon me të njëjtin zë në akt rakordimin me thesarin.

-Gjendja e llogarisë 7020 “*Tatim mbi pasurinë e paluajtshme*” pasqyrohet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 5,376,084 lekë, e cila rakordon me të njëjtin zë në akt rakordimin me thesarin.

- Gjendja e llogarisë 7032 “*Taksë mbi shërbimet specifike*” pasqyrohet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 1,273,334 lekë, e cila rakordon me të njëjtin zë në akt rakordimin me thesarin.

-Gjendja e llogarisë 7033 “*Takse mbi përdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie*” pasqyrohet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 3,672,481 lekë, e cila rakordon me të njëjtin zë në akt rakordimin me thesarin.

-Gjendja e llogarisë 7035 “*Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie*” pasqyrohet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 7,235,860 lekë, e cila rakordon me të njëjtin zë në akt rakordimin me thesarin.

-Gjendja e llogarisë 71 “Të ardhurat jo tatimore” paraqitet në bilancin e 2024 në vlerën 15,680,066 lekë, i cili kuadron me Akt rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

-Gjendja e llogarisë 7109 “*Të ardhura te tjera jo tatimore nga ndërmarrjet dhe pronësia*” paraqitet në bilancin e 2024 në vlerën 6,293,008 lekë, i cili kuadron me Akt rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

-Gjendja e llogarisë 7110 “*Tarifë administrative dhe rregullatorë*” paraqitet në bilancin e 2024 në vlerën 8,324,265 lekë, i cili kuadron me Akt rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

-Gjendja e llogarisë 7111 “*Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh*” paraqitet në bilancin e 2024 në vlerën 622,300 lekë, i cili kuadron me Akt rakordimin me thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

Gjendja e llogarisë 7113 “*Të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve*” paraqitet në bilancin e 2024 në vlerën 58,338 lekë, i cili kuadron me Akt rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

Gjendja e llogarisë 7115 “*Gjoha, kamatëvonesa, sekuestrime e zhdëmtime*” paraqitet në bilancin e 2024 në vlerën 382,155 lekë, i cili kuadron me Akt rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

- Gjendja e llogarisë së fondeve 72 “*Grante Korrente*” është në vlerën prej 436,136,047 lekë, vlerë e cila përbëhet nga:

-Gjendja e llogarisë 7201 “*Nga buxheti për NJQP (Vendore)*” paraqitet në bilancin e 2024 në vlerën 412,041,445 lekë, e cila kuadron me Akt rakordimin me thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

-Gjendja e llogarisë 7204 “*Pjesëmarrja e institucioneve në tatime nacionale*” paraqitet në bilancin e 2024 në vlerën 3,277,464 lekë, i cili kuadron me Akt rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

-Gjendja e llogarisë 7206 “*Financim i pritshëm nga buxheti*” paraqitet në bilancin e 2024 në vlerën 20,817,138 lekë, e cila kuadron me Akt rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

Analiza e shpenzimeve në vitin 2024, të cilat në total janë në vlerën 334,081,321 lekë paraqitet më poshtë:

- Gjendja e llogarisë 600 “*Paga, shpërblime e të tjera personeli*” për vitin 2024, paraqitet në bilanc në vlerën 166,776,161 lekë dhe sipas akt rakordimit me thesarin.

- Gjendja e llogarisë 601 “*Kontribute për sigurime*” për vitin 2024, paraqitet në bilanc në vlerën 28,067,061 lekë dhe sipas akt rakordimit me thesarin.

- Gjendja e llogarisë 602 “Blerje mallra e shërbime” paraqitet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 44,836,875 lekë dhe sipas akt rakordimit me Thesarin.
- Gjendja e llogarisë së fondeve 604 “Transferime korrente te brendshme” paraqitet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 1,240 lekë dhe sipas akt rakordimit me Thesarin.
- Gjendja e llogarisë së fondeve 606 “Transferime për buxhetet familjare e Individë” paraqitet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 94,037,081 lekë, e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin.
- Gjendja e “Shpenzime te tjera” për vitin 2024 paraqitet në bilanc në vlerën 135,416,607 lekë. Për vitin 2024 totali i të ardhurave në vlerë është 469,497,928 lekë dhe totali i shpenzimeve është 334,081,321 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 135,416,607 rakordon me gjendjen e llog.85 “Rezultatit e ushtrimit”.

Gjithashtu gjendja e llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” është e barabartë me ndryshimin e gjendjeve të klasës 3 në formatin 1 të bilancit, ku për vitin 2024 është në vlerën - 362,903 lekë.

#### **-Formati nr.6 “Investimet dhe burimet e financimit”.**

- Zëri "Burimet për investime" Format 6, i plotësuar për shumën 108,984,235 lekë në analizë tregon burimet e investimit nga buxheti i shtetit dhe nga fonde te veta.

Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës në lekë  
Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkuara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listë pagesa, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim.

Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

Për sa më sipër është mbajtur Akt-Konstatimi nr. 2, datë 10.06.2025. Nuk ka observacione nga subjekti nën auditim, në fazën e PRA-së.

### **3. Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.**

**3.1.** Hartimi i programit (Plan veprimi) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.

**3.2.** Realizimi i programit (plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6/mujor.

**3.3.** Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

*Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të dërguara në Bashkinë Fushë Arrëz nga KLSH me shkresën nr. 623/7.Prot, datë 09.08.2024.*

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se janë rekomanduar gjithsej:

- Nga 7 masa organizative të rekomanduara, rezulton se **1 është zbatuar plotësisht, 4 masa të pazbatuara, 1 është në proces zbatimi dhe 1 masë pjesërisht e zbatuar.**
- Nga 4 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve

*publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike si dhe uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë detyrimet nga qiradhënia(të ardhura të munguara), rezulton se:*

- *Nga 4 masa të rekomanduara, 1 masë e pazbatuar, 2 masa në proces dhe 1 masë zbatuar pjesërisht.*
- *masa disiplinore, rezulton se janë zbatuar, duke u dhënë 4 vërejtje për 4 punonjës.*

1. Bashkia Fushë Arrëz për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, ka nxjerrë plan veprimin sipas *shkresës nr.2621/Prot., datë 20.08.2024.* “Plan veprimi, për zbatimin e detyrave të lëna nga KLSH”, si dhe ka dërguar kthimin e përgjigjes mbi zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me nenin 15 germa “j”, të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

2. Bashkia Fushë Arrëz nuk ka dërguar raportim mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve në respektim të afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, veprime në kundërshtim me pikën 2 të nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

*Pa zbatuar*

3. Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH, siç përcaktohet në nenin 50 -Auditimi i jashtëm, pika 5, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

- Nga verifikimi rezulton se Bashkia Fushë Arrëz nuk ka raportuar në këshillin e njësisë (këshillin bashkiak), në mbështetje me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se; 5. *Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë për progresin në zbatimin e tij.*”

*Pa zbatuar*

**Nga verifikimi i dokumentacionit, në lidhje me nivelin e zbatimit të rekomandimeve në auditimet e mëparshme (2021-2023), konstatohet se niveli i zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:**

*Nga 3 masa të rekomanduara, për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike si dhe uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë detyrimet nga qiradhënia(të ardhura të munguara), rezulton se:*

-Nga 3 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike,(D1) rezulton se 2 masa janë të pazbatuara dhe 1 masë në proces.

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve paraqitet si vijon:

## **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2023 me të ardhurat e veta (pa transfertën e pakushtëzuar) të Bashkisë Fushë Arrëz ka diferenca të dukshme me vlerën e planifikuar. Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është akoma më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit, ku zëri shpenzime kapitale (artikulli 230 dhe 231) është planifikuar në vlerën **78,694 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **52,550 mijë lekë**, ose në masën 67 %. Ky mos realizim vjen si rezultat i mos arkëtimin të të ardhurave, ku nga vlera 28,555 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar vlera 22,568 mijë lekë ose

79%, me mos realizim në vlerën 5,987 mijë lekë çka do të thotë se nga Bashkia Fushë Arrëz në fillim të vitit buxhetor ka planifikuar angazhime buxhetore duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifave vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërm janë në kundërshtim me nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, pika (a) të nenit 5. Gjithashtu edhe gjatë vitit 2023 nuk është bërë analiza e zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor dhe nuk është dalë në konkluzion nëse duhej rishikuar ose jo buxheti vjetor 2023.

**1.1.Rekomandimi:** Sektori i Financës, në bashkëpunim me Ekippet e Menaxhimit të Programeve, të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme, si dhe të rishikuar përgjatë vitit, mbi bazë nevojash dhe mundësish realizimi, si për investimet ashtu edhe për shpenzimet për mallra e shërbime.

**Përgjigja e subjektit:**

Bashkia Fushë Arrëz ka realizuar këtë rekomandim, duke planifikuar saktë të ardhurat dhe duke realizuar dhe tejkalluar ato për vitin 2024. Kjo vërtetohet nga rakordimi me Degën e Thesarit Pukë për të ardhurat e këtij viti.

**Komenti i grupit të auditimit:** Nga verifikimi i rakordimit ndërmjet Bashkisë Fushë Arrëz dhe Degës së Thesarit Pukë, rezulton që zëri Investime (230-231), është realizuar në masën 84,11 %. Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe *i zbatuar*.

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezulton se për vitin 2023 të ardhurat janë në vlerën 28,555 mijë lekë të planifikuara dhe janë realizuar 22,568 mijë lekë ose 79%, me mos realizim në vlerën 5,987 mijë lekë, kryesisht në taksat e popullatës, si p.sh. taksa e ndërtesës, tarifa e pastrim-gjelbërimit, tarifë për shfrytëzimin e lëndëve drusore, etj., Konstatohet se:

- Taksa e mjeteve të përdorura është planifikuar sipas të dhënave historike pra nuk ka një data baze të saktë për numrin e mjeteve të përdorura që ka Bashkia Fushë Arrëz, Taksa e kalimit e të drejtës në pronësi nuk është planifikuar si burim i krijimit tatimor. Sektori i taksave dhe tarifave vendore, duke mos pasur një bazë të dhënash nuk ka bërë rakordime me Drejtorinë Rajonale Tatimore Shkodër (DRTB), Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHKK) dhe Drejtorinë e Shërbimit të Transportit (DSHTRR).

- Për detyrimet e abonentëve familjarë, Bashkia Fushë Arrëz nuk ka krijuar një bazë të dhënash të plotë dhe të saktë për familjet, ku të përcaktohet numri i familjeve dhe sasia e sipërfaqes së banimit që ka secila familje, kujt viteve i përket banesa, para apo pas vitit 1993, sa kanë paguar, sa nuk paguajnë dhe sa familje janë të përjashtuar nga pagesa e këtyre taksave, nuk është plotësuar rregullisht njoftimi i detyrimit për çdo familje, si për taksën e ndërtesës edhe për tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit. Për detyrimet e familjarëve, u konstatua se shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime rajonal është caktuar si Agjent Tatimor për vjeljen e taksës së ndërtesës e të truallit dhe tarifën e pastrimit dhe të shërbimit sipas paketës fiskale por nuk ka funksionuar.

Akt rakordimet me agjentët tatimorë nuk janë mbajtur sipas formatit të përcaktuar me Udhëzim të posaçëm nga Ministria e Financave. Rakordimet janë bërë në formë proces-verbalesh, duke marrë informacion vetëm për sasinë e arkëtimeve, por nuk mund të konsiderohen rakordime pasi nuk ka asnjë të dhënë statistikore në bazë të së cilës të bëhen llogaritjet dhe të vlerësohet niveli i mbledhjes së të ardhurave, veprime në pajtueshmëri me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**2.1.Rekomandimi:** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Fushë Arrëz të marrë masa për të krijuar një bazë të dhënash të plotë dhe të saktë për familjet, ku të përcaktohet numri i familjeve dhe sasia e sipërfaqes së banimit që ka secila familje si dhe të bëhet një analizë e hollësishme për planifikimin sa më real të të ardhurave për të mos krijuar diferenca të dukshme në realizimin e shpenzimeve buxhetore.

**Përgjigja e subjektit:** Është përgatitur urdhri nr. 181, datë 08.05.2024, për të gjitha Njësitë Administrative për të regjistruar në terren të gjitha familjet që janë aktualisht në Bashkinë Fushë

Arrëz. Është duke u punuar për kadastrën fiskale për regjistrimin e të gjitha familjeve dhe subjekteve që janë në territorin e Bashkisë Fushë Arrëz.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i llogarisë nr. 466 “*Kreditorë për mjete nën ruajtje*”, u konstatua se kjo llogari është pasqyruar më tepër për vlerën 9,194,316 lekë, e cila përfaqëson vlerën e garancive së kontratave në masën 5%, të cilave ju ka përfunduar afati i mbajtjes së garancisë. Bashkia Fushë Arrëz nuk ka njoftuar subjektet të cilave ju ka përfunduar afati i çlirimit të garancisë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 3.2 “*Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të të tretëve (klasa 4) – funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4*” në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*”, i ndryshuar.

**3.1.Rekomandimi:** Përgjegjësi i Sektorit të Financës në bashkëpunim me Sektorin e Urbanistikës, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr. 466 “*Kreditorë për mjete nën ruajtje*”, si dhe të njoftojë subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të likuiduar vlerën e garancisë, të cilave ju ka kaluar afati i përcaktuar në kontratë dhe investimi për të cilën është mbajtur garancia, është marrë në dorëzim.

**Përgjigja e subjektit:** Zyra e Financës ka njoftuar me shkresën nr. 389, datë 10.2.2025, Zyrën e Menaxhim Territorit dhe Investimeve duke dërguar listën e objekteve me shumat përkatëse dhe kodin e secilit projekt. Zyra e Menaxhimit të Territorit dhe investimeve ka kontaktuar me telefon me subjektet përfituese dhe disa prej tyre janë paraqitur për të sjellë dokumentacionin për likuidim. Janë likuiduar nga Bashkia Fushë Arrëz, për 5 % e mbajtjes së garancisë, për subjektet të cilave u ka kaluar afati, në lidhje me 5 objekte të përfunduar në vlerën 2,100,432 lekë.

**Komenti i grupit të auditimit:** Zyra e Menaxhimit të Territorit dhe Investimeve, nuk i ka kryer njoftimet shkresore subjekteve të cilëve ju ka përfunduar afati i çlirimit të garancisë.

Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe ***pjesërisht i zbatuar***.

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi se në Bashkinë Fushë Arrëz dhe njësitë administrative të saj, nuk është miratuar lista përfundimtare e pasurive të paluajtshme. Konkretisht për Bashkinë Fushë-Arrëz është miratuar lista paraprake e inventarit të pronave, me qëllim afishimin e tyre dhe përditësimin e ndryshimeve në listën përfundimtare të pronave, ndërsa ish-komunat, aktualisht njësi administrative nuk kanë as inventar paraprak. Në këtë inventar të hartuar nga Bashkia Fushë-Arrëz nuk janë përcaktuar zonat kadastrale dhe numrat e pasurive për identifikimin e pronave. Për rrjedhojë, inventarët e pronave të paluajtshme nuk përfaqësojnë një pasqyrë reale të gjendjes faktike të këtyre pasurive, për shkak se nga ana e Bashkisë Fushë-Arrëz nuk është rakorduar me Drejtorinë Vendore të ASHK-së mbi statusin juridik dhe tjetërsimin e mundshëm të pronave nga persona të tretë, përmes procedurave të legalizimit, privatizimit, vendimet e kthimit/kompensimit apo vendimet gjyqësore. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 37, të ligjit nr.20/2020 “*Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë*”.

**4.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës dhe të marrë masa për të krijuar një inventar të integruar për ish-komunat dhe për të koordinuar me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës me qëllim miratimin e inventarëve përfundimtare dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme.

**Përgjigja e subjektit:** Në strukturën e vitit 2024, është miratuar një pozicion për Specialist kadastrë dhe GIS. Me urdhër nr. 582, date 1/12/2023 është ngritur grupi i punës për të realizuar

këtë proces.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti *dhe i pazbatuar*.

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi administrimin e asetëve, procedura e inventarizimit si dhe regjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës rezulton se Bashkia Fushë Arrëz, nuk është krijuar struktura e posaçme e bashkëpunimit me drejtorinë përkatëse të ASHK-së, të cilat rakordojnë ndërmjet tyre, me qëllim realizimin e procedurave për përditësimin e inventarit, sikurse parashikohet në VKM nr. 28 datë 27.01.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve”.

Me urdhrin nr. 582 datë 01.12.2023 të Kryetarit të Bashkisë është ngritur grupi i punës i përbërë nga 4 anëtarë për përgatitjen e dokumentacionit për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme të bashkisë, për të cilën janë ngarkuar sektori i urbanistikës, sektori i financës dhe specialisti i kadastrës. Por, zbatimi i këtij urdhri me objektin e VKM-së përkatëse, nuk mund të realizohet në kushtet kur Bashkia Fushë-Arrëz dhe ish-komunat që i janë bashkuar territorit administrativ të saj nuk kanë të miratuar inventarin përfundimtar me Vendim të Këshillit të Ministrave, e si pasojë në mungesë të këtij akti, ASHK nuk mund të kryejë regjistrime bazuar në listën e inventarit paraprak.

**5.1.Rekomandimi:** Bashkia Fushë Arrëz të marrë masa për të krijuar një sektor të posaçëm për kadastrën, si pjesë të strukturës organike, me qëllim realizimin e detyrave për hartimin dhe përditësimin e inventarëve të pasurive të paluajtshme të bashkisë, përfshirë ish-komunat, aktualisht njësi administrative.

**Përgjigja e subjektit:** Në strukturën e vitit është miratuar një pozicion për Specialist kadastrë dhe GIS. Me urdher nr. 582, date 1/12/2023 është ngritur grupi i punës për të realizuar këtë proces.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti *dhe i pazbatuar*.

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi është konstatuar se për pasuri të paluajtshme të ndërtuara me investime nga Bashkia Fushë-Arrëz për periudhën 2015-2023 janë gjithsej dy objekte të cilat nuk janë regjistruar në regjistrat e pasurive publike, konkretisht si vijon:

- Palestra e shkollës së mesme, me sipërfaqe 458 m<sup>2</sup> me vlerë investimi 49,554,052 lekë, shtrihet në pasurinë me nr. 51, vol.3 faqe 245 me sipërfaqe 3890 m<sup>2</sup> truall në pronësi shtet. Ky objekt është ndërtuar me leje ndërtimi nr.6 datë 03.07.2019 por Bashkia nuk ka regjistruar truallin funksional të objektit e për rrjedhojë nuk mund të realizohet regjistrimi në kadastër.

- Godina e njësisë administrative Blerim me sipërfaqe 118.8 m<sup>2</sup> me vlerë investimi 5,628,804 lekë nuk ka leje ndërtimi si dhe nuk ka asnjë informacion juridik për statusin e truallit ku është zhvilluar ndërtimi për rrjedhojë nuk mund të realizohet regjistrimi në kadastër. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 12, të ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

**6.1.Rekomandimi:** Bashkia Fushë Arrëz të marrë masa ligjore dhe administrative për të regjistruar në regjistrat publikë të pasurive të paluajtshme të ASHK-së, palestrën e shkollës së mesme dhe godinën e njësisë administrative, së bashku me truallin përkatës funksional.

**Përgjigja e subjektit:** Zyra e Financës dhe Buxhetit me *shkresën nr. 388, datë 10.02.2025*, ka njoftuar Zyrat përkatëse për këtë rekomandim për të regjistruar në pasqyrat financiare të vitit korrent.

**Komenti i grupit të auditimit:** Nuk ka përgjigje nga Zyra e Menaxhimit të Territorit dhe Zyra e Administrimit të Pyjeve, për të regjistruar në regjistrat publikë të pasurive të paluajtshme të ASHK-së, palestrën e shkollës së mesme dhe godinën e njësisë administrative, së bashku me truallin përkatës funksional.

Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti *dhe i pazbatuar*.

**7. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Fushë-Arrëz ka në administrim një fond pyjor dhe kullor prej 45,667.54 ha. Lista e inventarit të pyjeve dhe kullotave është miratuar me VKM nr.433 datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, të ndryshuar. Me VKM nr.60 datë 26.01.2022 “Për Shpalljen e ekosistemeve natyrore Rezervat Natyror i Menaxhuar / Park Natyror (Kategoria IV) si dhe miratimin e ndryshimit të statusit e të sipërfaqeve ekzistuese të zonave të mbrojtura mjedisore që i përkasin kësaj kategorie” dorëzuar ADZM Shkodër, nga totali i një sipërfaqeje prej 49,304.24 Ha pyje/kullota është zbritur sipërfaqja 3,636.70 Ha e zonave të mbrojtura, e si rrjedhojë vetëm 45,667.54 ha kanë mbetur në administrim të Bashkisë. Në lidhje me menaxhimin e fondit pyjor, sipas detyrimeve të nenit 17 të ligjit nr.57/2020 “Për Pyjet”, Bashkia Fushë-Arrëz nuk ka hartuar plane mbarështimi për ekonominë pyjore. Në kundërshtim me pikën 66 të VKM nr.443/2016 nuk ka regjistruar në regjistrat kadastrale sipërfaqet e fondit pyjor dhe kullor publik. Në Zyrën Vendore të ASHK Pukë rezultojnë se janë çelur kartela të pasurive të paluajtshme për 3217 pasuri pyje dhe kullota, për të cilat Bashkia Fushë-Arrëz nuk ka aplikuar për certifikatë pasurie, me arsyetimin për mungesë fondesh të planifikuara për këtë qëllim.

**7.1.Rekomandimi:** Bashkia -Fushë Arrëz të marrë masa për të planifikuar fonde me qëllim hartimin e planeve të mbarështimit për ekonominë pyjore si dhe të aplikojë për pajisjen me certifikata pronësie, duke i dhënë përparësi ngastrave pyjore për të cilat janë lidhur kontrata për dhënien në përdorim të fondit pyjor.

**Përgjigja e subjektit:** Në buxhetin e vitit 2024 dhe 2025 janë planifikuar fonde për hartimin e planeve të mbarështimit për ekonomi pyjore të ndryshme, konkretisht për vitin 2024 janë planifikuar 4,023 mijë lekë dhe për vitin 2025 janë planifikuar 3,700 mijë lekë.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti *dhe në proces*.

## **A.1. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM.**

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve, në mënyrë të përmbledhur, rezultoi se: Me shkresën nr. 871/12.prot., datë 24.01.2024, nga Kontrolli i Lartë i Shtetit është dërguar Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet të ushtruar në Bashkinë Fushë Arrëz për të cilat nuk është shprehur për pranimin ose refuzimin e rekomandimeve të lëna, nuk ka hartuar “Plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve, me persona përgjegjës”, si dhe nuk ka kthyer përgjigje në KLSH brenda 20 ditësh dhe periudhës së 6 muajve. Gjithashtu Bashkia Fushë Arrëz nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak dhe nuk ka raportuar në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit. Nga verifikimi i masave të rekomanduara, rezultoi se:

a. Nga 15 masa organizative, të cilat janë pranuar nga Bashkia Fushë Arrëz, janë zbatuar 2 masa, janë në proces zbatimi 10 masa, dhe janë zbatuar pjesërisht 3 masa.

b. Nga 2 masa për eliminimin e efekteve negative të cilat janë pranuar dhe zbatuar.

c. Nga 2 masa për arkëtimin e të ardhurave të cilat janë pranuar, ku njëra është zbatuar pjesërisht dhe masa tjetër nuk është zbatuar.

d. Janë rekomanduar 5 masa disiplinore, të cilat janë zbatuar.

Sa më sipër veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, netët 15 dhe 30, pika 2 dhe Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, “Auditimi i jashtëm”, pika 5.

**8.1. Rekomandimi:** Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju ri

kërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përshejtimin e atyre në proces si më poshtë:

**2.2 Rekomandimi:** Zyra e Taksave dhe të Ardhurave Vendore, në bashkëpunim me Zyrën Juridike, të marrin masa që për aq sa është e mundur të identifikohet, të filloje procedura e marrjes së masave shtrënguese për vjeljen e të ardhurave të munguara, nëpërmjet bllokimit të llogarive, kallëzimeve penale apo mënyrave të tjera që parashikon legjislacioni në fuqi.

**Përgjigja e subjektit:** Në lidhje *me rekomandimin 2.2, nuk ka përgjigje.*

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa më sipër, rekomandimi 2.2; konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe është *i pazbatuar.*

**3.1 Rekomandimi:** Zyra e Shërbimeve Publike të marrë masa për pajisjen me autorizimet përkatëse të të gjithë subjekteve që operojnë në fushën e tregtimit të hidrokarbureve dhe pas plotësimit të dosjeve përkatëse me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, të rakordojë me zyrën e Taksave dhe të Ardhurave Vendore për përlllogaritjen dhe vjeljen e detyrimeve nga pajisja me autorizime.

**Përgjigja e subjektit:** Në lidhje *me rekomandimin 3.1*, janë njoftuar subjektet me shkresat nr. 686.Prot., datë 11.3.2024, nr. 688.Prot., datë 11.3.2024, 687.Prot., datë 11.3.2024 dhe 681.Prot datë 11.3.2024.

Janë hartuar 3 akt-marrëveshje për likuidimin e detyrimit me subjektin “V. T. ShPK” me nr. 827.Prot., datë 25.3.2024, Subjektin “N 1990 ShPK” me nr. 2219.Prot., datë 9.7.2024, Subjektin “L. ShPK” me nr. 4416.Prot., date 21.11.2024.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Për sa më sipër, rekomandimet 3.1, konsiderohet i pranuar nga subjekti *dhe pjesërisht i zbatuar.*

**4.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz, si dhe drejtorët e drejtorive dhe përgjegjësit e sektorëve, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të risqeve, me qëllim menaxhimit e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza, kontrolli dhe përditësimi 2 herë në vit i risqeve që mund të kenë efekt negativ në arritjen e objektivave të institucionit.

**Përgjigja e subjektit:** Sa i përket *rekomandimit 4.1*, Bashkia Fushë Arrëz nuk ka marrë masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të risqeve, me qëllim menaxhimit e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza, kontrolli dhe përditësimi 2 herë në vit i risqeve që mund të kenë efekt negativ në arritjen e objektivave të institucionit.

Gjatë procesit të auditimit u konstatua përsëritje e problematikave të mëparshme, për të cilat ishin dhënë rekomandime që rezultojnë ende të pazbatuara. Me qëllim unifikimit dhe rritjen e efektivitetit të ndjekjes së masave korrigjuese, rekomandimet e përsëritura do të konsiderohen në një të vetme dhe do të ri kërkohen në mënyrë të centralizuar në vijim të këtij raporti.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Për sa më sipër, rekomandimi 4.1 konsiderohet i pranuar nga subjekti *dhe i pazbatuar.*

## **B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të buxhetit lidhur me likuidimin e detyrimeve të prapambetura rezulton se Bashkia Fushë Arrëz për zbatimin e vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve, për vitin 2023 ka shpenzuar vlerën 5,515,568 lekë, për 7 raste, sipas aneksit nr. 3 pika 1 bashkëlidhur raportit të auditimit, *të cilat përbëjnë shpenzime pa economicitet, eficiencë dhe efektivitet, pasi praktikisht për një pozicion pune paguhen dy persona.* Gjithashtu konstatohet se për likuidimet e subjekteve të mësipërme janë nxjerrë urdhrat përkatës nga titullari i institucionit, por nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë

dhe nuk është kërkuar prej tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet. Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me pikën nr. 60, të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

**1.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatojë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kane sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

**Përgjigja e subjektit:** Zyra Juridike ka përgatitur nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Bashkisë një analizë për të gjitha vendimet e gjykatës të cilat kanë prodhuar kosto për Bashkinë tonë, duke parë me kujdes shkaqet në mënyrë që të mos përsëriten në vazhdim këto problematika. Gjatë vitit 2024, nuk ka pasur procese gjyqësore të reja për largime nga puna.

#### **Komenti i grupit të auditimit:**

Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti *dhe në proces*.

### **B.I. MASA PËR ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA.**

**1.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datë 31.12.2023 gjendja e debitorëve nga taksat e tarifave vendore për subjektet fizikë/juridikë paraqitet në shumën 21,319,900 lekë për 74 subjekte, nga e cila biznesi i madh në vlerën 8,528,626 lekë për 39 subjekte, biznesi i vogël në vlerën 10,201,374 lekë për 29 subjekte dhe institucionet në vlerën 2,589,900 lekë për 6 subjekte. Niveli i detyrimeve të pa arkëtuara në vitin 2023 në krahasim me vitin 2022 vjen në rritje për vlerën 1,859,987 lekë, ku nga vlera 19,459,913 lekë për 38 subjekte (në fund të vitit 2022), në fund të vitit 2023 paraqiten në shumën 21,319,900 lekë për 74 subjekte, vlerë e cila do të konsiderohet detyrime të pa arkëtuara në buxhetin e bashkisë Fushë Arrëz.

Rezulton se sektori i taksave, dhe tarifave vendore në Bashkia Fushë Arrëz nuk ka llogaritur penalitete (kamatëvonesë), për mos likuidim në afat të detyrimeve si dhe nuk ka ndërmarrë asnjë procedurë për bllokimin e llogarive bankare. *Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Kreun XI-Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar*, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime; ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni nenet 15 dhe 181 -Mospagimi i taksave dhe tatimeve, apo të parashikimit të vendimeve (vlerave) të gjobave të përcaktuara në nenin 46 të ligjit “Për Kundërvajtjet Administrative” (brenda 2 viteve), ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 -Mospagimi i taksave dhe tatimeve, me pikat 3,4, 5 dhe 5, të nenin 45 – “Çregjistrimi i subjekteve tatimore”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, me ndryshime.

**1.1.Rekomandimi:** Sektori i Taksave, dhe Tarifave në Bashkinë Fushë Arrëz, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifave vendore në fund të vitit 2023 në vlerën **21,319,900 lekë**, duke ndjekur etapat si më poshtë vijon:

*a-T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.*

*b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për*

mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme),.

*c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.*

*d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Sektori i Taksave dhe Tarifave dhe Sektori Juridik, të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.*

**Përgjigja e subjektit:** Janë përgatitur të gjitha njoftimet, por shkak të ndalimeve që ka kodi zgjedhor, nuk janë shpërndarë akoma.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti *dhe i pazbatuar.*

**2. Gjetje nga auditimi:** Për vitin 2023 është lidhur vetëm një kontratë qiraje me nr.prot.1167 datë 19.04.2023 për dhënien në përdorim të fondit pyjor mes shoqërisë “K” ShPK për “Linjë elektrike dhe sipërfaqe ndihmëse në funksion të impiantit eolik”. Objekti i kësaj kontrate është dhënia në përdorim e një sipërfaqeje prej 8.0345 ha, nga e cila 732,345 ha/4.823 km linjë elektrike +0.8 ha sipërfaqe pyjore, që shtrihen në ekonomitë pyjore Iballë-Mezi, Lumi i Berishës, Qafë Plakë -Qafë Shari, me vlerë 1,076,982 lekë, e cila është paguar.

Në lidhje me debitorët nga kontratat e qirasë, për vitin 2023 rezultojnë 7 subjekte në vlerën 2,119,232.5 lekë, nga të cilat 3 subjekte kanë si objekt të aktivitetit vendosjen e antenave, 3 subjekte kanë si objekt të aktivitetit HEC, ndërsa 1 subjekt ka si objekt veprimtaritë në fushën e minierave.

**2.1.Rekomandimi:** Bashkia Fushë Arrëz të marrë të gjitha masa ligjore dhe administrative për arkëtimin e vlerës prej 2,119,232 lekë për debitorët që rezultojnë nga kontratat e qirasë së fondit pyjor.

**Përgjigja e subjektit:** Në lidhje me këtë rekomandim Bashkia Fushë Arrëz sqaron se nga 7 (shtatë) subjekte debitorë, 5 (pesë) prej tyre kanë kryer pagesat pas njoftimeve të marra nga ana jonë dhe konkretisht:

1. A. ka kryer pagesën prej 314,000 lekë me datë 29.08.2024.
2. T. ka kryer pagesën prej 212,250 lekë me datën 14.2.2025.
3. E. ka kryer pagesën prej 917 875 lekë me datën 17.2.2025.
4. O A. ka kryer pagesën prej 78 875 me datë 8.2.2024.
5. V. A ka kryer pagesën prej 300 000 lekë me datë 29.8.2024.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Gjatë procesit të auditimit u konstatua përsëritje e problematikave të mëparshme, për të cilat ishin dhënë rekomandime që rezultojnë ende të pazbatuara. Me qëllim unifikimin dhe rritjen e efektivitetit të ndjekjes së masave korrigjuese, rekomandimet e përsëritura do të konsiderohen në një të vetme dhe do të ri kërkohen në mënyrë të centralizuar në vijim të këtij raporti

Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti *dhe pjesërisht i zbatuar.*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se nga Bashkia Fushë Arrëz në fund të vitit ushtrimor 2023 ushtrojnë aktivitetin 4 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. Nga auditimi i kësaj kategorie të bizneseve, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se *subjekti “V T” ka lidhur marrëveshje me bashkinë duke filluar likuidimin e detyrimeve të prapambetura dhe pajisjen me autorizim 1 vjeçar, ndërsa 3 subjektet e tjera respektivisht subjekti K. O. SHPK, subjekti L. SHPK dhe D. SHPK nuk janë pajisur me autorizim 5 vjeçar si dhe nuk kanë paguar detyrimet në vlerën 5,000,000 lekë, në kundërshtim me VKM nr. 344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.970, datë 2.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e*

procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”.

**3.1.Rekomandimi:** Zyra e Shërbimeve Publike të marrë masa për pajisjen me autorizimet përkatëse të të gjithë subjekteve që operojnë në fushën e tregtimit të hidrokarbureve dhe pas plotësimit të dosjeve përkatëse me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, të rakordojë me zyrën e Taksave dhe të Ardhurave Vendore për përlogaritjen dhe vjeljen e detyrimeve nga pajisja me autorizime për 3 subjektet respektivisht:

K. O. SHPK me NIPT L.A në vlerën 1,000,000 lekë;

L. SHPK me NIPT L.O në vlerën 2,000,000 lekë;

D. SHPK me NIPT K.C në vlerën 2,000,000 lekë;

**Përgjigja e subjektit:** Në lidhje me *rekomandimin 3.1* janë njoftuar subjektet me shkresat nr. 686.Prot, datë 11.3.2024, nr. 688.Prot datë 11.3.2024, 687.Prot datë 11.3.2024 dhe 681.Prot datë 11.3.2024. Janë bërë marrëveshje për likuidimin e detyrimit me subjektin “V T ShPK” me nr. 827.Prot, datë 25.3.2024, Subjektin “N.1990 ShPK” me nr. 2219.Prot. datë 9.7.2024, Subjektin “L ShPK” me nr. 4416.Prot., date 21.11.2024.

Ka shlyer detyrimin e plotë sipas akt marrëveshjes, subjekti “V T oil ShPK” me nr. 827.Prot, datë 25.3.2024, në vlerën 1,400, 000 lekë.

Ka shlyer detyrimin e vitit 2024, Subjekti “N. 1990 ShPK”, në vlerën 200,000 lekë.

Ka shlyer detyrimin e vitit 2024, Subjekti “L. ShPK” sipas akt marrëveshjes me nr. 4416.Prot. date 21.11.2024, në vlerën 306,666 lekë si dhe në vitin 2025 ka kryer edhe një pagesë në vlerën 200,000 lekë.

#### **Komenti i grupit të auditimit:**

Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti *dhe në proces*.

#### **D. MASA DISIPLINORE.**

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 germa b, c dhe ç, ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore”, pika 1 dhe pika 4 germa b, VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Fushë Arrëz t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse.

**Përgjigja e subjektit:** Bashkia Fushë Arrëz në zbatim të rekomandimit të mësipërm ka bërë analizimet përkatëse sipas strukturave ligjore duke marrë masa disiplinore “vërejtje” për 4 persona. Një person rezulton i larguar nga puna (O. Ç). (Shkresa me nr. 1737, datë 28.05.2024, për shqyrtimin e masave disiplinore).

#### **Komenti i grupit të auditimit:**

Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti *dhe i zbatuar*.

#### ***Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:***

Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm paraqitet si më poshtë:

Emërtimi	Rekomanduar	Zbatuar	Pa zbatuar	Në proces	Pjesërisht zbatuar
Masa Organizative	7	1	4	1	1
Masa 3 E dhe Ulje e Borxhit	1			1	
Masa për arkëtimin e detyrimeve Tatimore	3		1	1	1
<b>Total</b>	<b>11</b>	<b>1</b>	<b>5</b>	<b>3</b>	<b>2</b>

Përpunoi grupi i auditimit

Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimet e viteve 2020-2022 paraqitet si më poshtë:

Emërtimi	Rekomanduar	Zbatuar	Pa zbatuar	Pjesërisht i zbatuar
Uljen e Borxhit	3		2	1
<b>Total</b>	<b>3</b>		<b>2</b>	<b>1</b>

Përpunoi grupi i auditimit

- Bashkia Fushë Arrëz, nuk ka respektuar afatin 6 - mujor të kthimit të përgjigjes për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, në kundërshtim me nenin 30, pika 2 e Ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

- Bashkia Fushë Arrëz nuk ka marrë të gjithë masat e nevojshme për zbatimin e plotë të rekomandimeve.

**-Niveli i pranimit të rekomandimeve është 100% dhe realizimi në masën 9 % zbatuar, pa zbatuar në nivelin 45,45%, në proces apo zbatuar pjesërisht në nivelin 45,45 %.**

**- Niveli i zbatimit të rekomandimeve nga auditimet e viteve të kaluar:**

Gjithsej 3 rekomandime të cilat janë **2 masa pa zbatuar** dhe **1 masë pjesërisht e zbatuar**.

Pra nuk rezulton asnjë masë e zbatuar plotësisht.

Sa më sipër veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, netët 15 dhe 30, pika 2 dhe Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, “Auditimi i jashtëm”, pika 5.

Mbajnë përgjegjësi:

- z. H.C., Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz;
- z. V. P., Përgjegjës i Sektorit të Tatim Taksave;
- Znj. B. C. dhe znj, A.V., z. A. Z. dhe znj. Z. B., në rolin e specialistëve të sektorit të Tatim Taksave.
- Znj. R. H., përgjegjëse e sektorit juridik;
- z. A. D. Drejtor i Drejtorisë së Administrimit të pyjeve dhe kullotave;
- z. T. P., përgjegjës i sektorit të Urbanistikës dhe Kontrollit të terrenit.

Nuk ka observacione nga subjekti nën auditim në fazën e RPA-së.

#### **Pika 4. Të ndryshme të dala gjatë auditimit**

Nga auditimi konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2024 me të ardhurat e veta (pa transfertën e pakushtëzuar) të Bashkisë Fushë Arrëz nuk ka diferenca negative me vlerën e planifikuar madje është tejkaluar planifikimi, të ardhurat e vitit të planifikuara janë 28,555 mijë lekë ndërsa realizimi i tyre është 45,553 mijë lekë ose 159.5%. Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është më i lartë se mesatarja e realizimit të buxhetit (79%), ku zëri shpenzime kapitale (artikulli 230 dhe 231) është planifikuar në vlerën **136,518 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **108,984 mijë lekë**, ose në masën 80 %.

Tabela 1

NR	EMERTIMI	PLAN	FAKT	%
1	Tatim i thjesht Fitimi	50,000	124,056	248.1
2	Taksë mbi token bujqësore	1,625,000	78,620	4.83
3	Taksë ndërtese	2,700,000	3,039,517	112.5
4	Taksë trualli	1,800,000	2,257,947	125.4
5	Taksa te tjera te ngjashme (tarifë/taksa)	100,000	1,273,334	1273.3
6	Taksa vjetore e mjeteve te përdorura	3,600,000	3,672,481	102

7	Tarifë zënie hapësire publike	150,000	150,345	100.2
8	Taksë ndikimi ne infrastrukturë	100,000	130,200	130.2
9	Taksë ndriçimi, tabelle	435,000	327,525	75.2
10	Te ardhura nga shitja e druve te zjarrit	1,600,000	5,820,516	363.7
11	Tarifë për leje karburanti	800,000	433,334	54.1
12	Tarifë për leje ndërtimi	700,000	373,940	53.4
13	Të Ardhura nga Qiratë nga toka bujqësore	68,000	67,580	99.3
14	Të Ardhura nga Qiratë	5,300,000	6,225,428	117.4
15	Tarifë për leje transporti	450,000	330,610	73.4
16	Tarifë pastrimi	4,000,000	7,993,655	199.8
17	Të Ardhura Jo Tatimore	620,000	598,300	96.5
18	Tarifë parkingu	60,000	24,000	40
19	Të Ardhura nga MZSH	27,000	58,338	216
20	Të Ardhura nga GJOBA	100,000	382,155	382.1
21	Tatim mbi te Ardhurat Personale 2%	2,150,000	3,277,464	152.4
22	Të Ardhura te tjera (grande+sponsorizime)	100,000	8,913,862	8913.8
23	Taksë fjetje ne hotel	20,000	-	0.0
24	Taksë nga renta minerare	2,000,000	-	0.0
25	Taksë për Zyrën e Regjistrimit te Pasurisë	-	-	0.0
<b>Totali:</b>		<b>28,555,000</b>	<b>45,553,207</b>	<b>159.52</b>

Burimi, Drejtoria e Financës

**Konstatim:** Nga auditimi konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2024 me të ardhurat e veta (pa transfertën e pakushtëzuar) të Bashkisë Fushë Arrëz nuk ka diferencë negative me vlerën e planifikuar madje është tejkaluar. Të ardhurat për vitin 2024 të planifikuara janë 28,555 mijë lekë ndërsa realizimi i tyre është 45,553 mijë lekë ose 159.5%.

Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është më i lartë se mesatarja e realizimit të buxhetit (79%), ku zëri shpenzime kapitale (artikulli 230 dhe 231) është planifikuar në vlerën **136,518 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **108,984 mijë lekë**, ose në masën 80 %. Ky tejkalim vjen si rezultat i mos planifikimeve saktë të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara, veprime në kundërshtim me nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, pika (a) të nenit 5.

## IV GJETJE DHE REKOMANDIME

### A- MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Bashkia Fushë-Arrëz nuk ka një sistem të qartë për informimin e punonjësve mbi ligjet, rregulloret dhe etikën. Mungojnë procedurat për raportimin dhe trajtimin e shkeljeve etike, si dhe programet e trajnimit për integritet dhe menaxhim financiar. Nuk ekzistojnë mekanizma për ankesa mbi korrupsionin. Mjedisi i kontrollit është i dobët dhe sistemi i kontrollit të brendshëm rezultojnë joefektiv, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a, b, c, ç, d, dh, e, ë, Kreu III, neni 20.

Nuk ekziston një sistem funksional për menaxhimin dhe raportimin e risqeve, përfshirë riskun e mashtrimit, i cili të vlerësojë në mënyrë periodike veprimet e punonjësve.

Regjistri i risqeve nuk është protokolluar dhe mungon strategjia për menaxhimin e tyre. Titullari nuk ka ngritur grupin teknik koordinues dhe mungon raportimi i risqeve të menaxherët përkatës. Nuk ka plan-veprime për menaxhimin e riskut, dhe ndikimet nga riorganizimi strukturor nuk janë reflektuar në sistemin e kontrollit të brendshëm, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a, b, c, ç, d, dh, e,

ë, Kreu II, neni 16, pika 2, Kreu III, neni 22, pika 1; (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1.1, faqe 10-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Fushë-Arrëz të marrë masa e të përcaktojë një proces të qartë për informimin e punonjësve mbi ligjet, rregulloret dhe etikën, si dhe të hartojë procedura për raportimin dhe trajtimin e shkeljeve etike.

*Në vijimësi*

**1.2 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Fushë-Arrëz të marrë masa të hartojë dhe miratojë një plan veprimi vjetor operacional dhe të ngrejë një strukturë funksionale për menaxhimin e riskut ku të përfshijë krijimin e strategjisë dhe regjistrin të risqeve, përfshirjen e riskut të mashtrimit në vlerësimet periodike, ngritjen e grupit teknik koordinues dhe krijimin e një sistemi raportimi për shkeljet.

*Menjëherë*

**2. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Fushë-Arrëz nuk ka procedura të qarta dhe të miratuara për ruajtjen, përdorimin dhe arkivimin e dokumentacionit. Mungojnë sisteme funksionale të TI-së jashtë atyre qeveritare si dhe nuk janë përcaktuar procedura për sigurinë e sistemit, mbrojtjen nga ndërhyrjet e paautorizuara dhe rikuperimin e të dhënave në rast fatkeqësish. Nuk ekziston ndarja e detyrave në sistemet TI për të shmangur përqendrimin e përgjegjësive në një individ. Bashkia nuk ka një sistem rezervë (back-up) funksional dhe të testuar, dhe nuk ka procedura të shkruara për rikuperim të të dhënave.

Mungojnë gjithashtu procedura të shkruara për kontrollin e integritetit dhe sigurisë së të dhënave financiare, si rakordimet mujore të llogarive, aksesin në të dhëna kontabël dhe auditimin e veprimeve, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*", Kreu II, neni 8, pika a, b, c, ç, d, dh, e, ë, Kreu II, neni 16, pika 2, Kreu III, neni 22, pika 1. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1.1, faqe 10-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Fushë-Arrëz të hartojë dhe miratojë procedura të qarta për ruajtjen, përdorimin dhe arkivimin e dokumentacionit, në përputhje me legjislacionin dhe nevojat institucionale duke zhvilluar sisteme funksionale të TI-së përtej atyre qeveritare dhe të vendosë masa për sigurinë e tyre, duke përfshirë ndarjen e detyrave, mbrojtjen nga ndërhyrjet e paautorizuara, si dhe krijimin e një sistemi efektiv të back-up-it dhe rikuperimit të të dhënave, të testuar në praktikë.

- Të hartojë procedura të shkruara për kontrollin e integritetit dhe sigurisë së të dhënave financiare, përfshirë rakordimet, aksesin dhe auditimin e tyre.

*Brenda vitit 2025*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i veprimtarisë së sektorit të auditit të brendshëm, për vitin 2024, u konstatua se:

- Auditimi i kryer nga Njësia e Auditimit të Brendshëm ka qenë formal dhe jo analitik, pasi nuk janë përfshirë në programet e auditimeve tërësia e veprimtarisë financiare dhe administrative e institucionit.

-Subjektet e audituara nuk kanë paraqitur Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve, në zbatim të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015, "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*" dhe Manualit të Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli IV, Pika 4.1.12. Hapi 11, "*Raportet e auditimit dhe plotësimi i plan veprimit nga njësia e audituar*".

-Programi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Njësinë e Auditimit të Brendshëm për vitin 2024 është hartuar dhe miratuar me urdher nr. 253 datë 21.06.2024, por nuk është dërguar pranë Strukturës Përgjegjëse të Harmonizimit në MFE, në kundërshtim me *Ligjin Nr.114 datë*

20.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, neni 12. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1.1, faqe 10-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1 Rekomandimi:** Subjektet e audituara në Bashkinë Fushë Arrëz, duhet të përgatisin dhe paraqesin Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditimit, sipas kërkesave ligjore dhe manualit për auditimin e brendshëm.

-Njësia e Auditit të Brendshëm të marrë masa për dërgimin e Programit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Strukturës Përgjegjëse të Harmonizimit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, për të siguruar transparencë dhe përputhje me procedurat zyrtare.

- Njësia e Auditimit të Brendshëm në bazën të analizës së riskut të kryejë auditime të thelluara dhe analitike, me qëllim përmirësimin, vlerësimin dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në bashki.

*Brenda vitit 2025*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se gjendja e llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” në mbyllje të vitit ushtrimor 2024 paraqitet në vlerën 122,100,000 lekë. Në këtë llogari nuk janë pasqyruar ndryshimet e nevojshme në vlerën 332,648 lekë që vijnë si pasojë e transferimit të Shoqërisë Rajonale Ujësijellës Kanalizime Shkodër, për 0.86% të aksioneve që zotëron Bashkia Fushë Arrëz. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit Ndërkombëtar nr.28 “Investime për Pjesëmarrje”, pika 35, si dhe Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr.5 “Aktive Afatgjatë Materiale dhe Aktive Afatgjatë Jo material”, pika 55,56. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 26-44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1.Rekomandimi:** Nëpunësi zbatues, të marrë masa për të bërë sistemimet e duhura në kontabilitet për transferimin e aksioneve 0.86% të Ujësijellës Kanalizime sh.a në vlerën 332,648 lekë, në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5.

*Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2025*

**5. Gjetje nga auditimi:** Në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2024, gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, është për vlerën kontabël 9,194,316 lekë. Sipas analizës së kësaj llogarie të rakorduar me degën e thesarit, kjo llogari është për vlerën 11,622,136 lekë dhe është e analizuar sipas objekteve për 42 raste, për vitin 2023 si dhe nuk është bërë çlirimi i garancive për vitin ushtrimor 2024. Gjatë vitit 2024 shuma e likuiduar është 2,100,432 lekë. Rezulton se janë plotësuar afatet kontraktuale për likuidimin e vlerës së garancisë, nga ditari i marrëdhënieve me Thesarin, por nga Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Shërbimeve, nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse sipas aneksit nr. 5 analiza e llogarisë 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje”, veprime në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. III, pikat 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 26-44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1.Rekomandimi:** Nëpunësi autorizues dhe Nëpunësi zbatues i njësisë vendore, të marrë masa për të zbatuar procedurat ligjore për likuidimin e vlerës 11,622,136 lekë sipas objekteve përkatëse dhe kontratave që këto subjekte kanë me njësinë vendore, të evidentuara në llogarinë nr. 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”.

*Brenda vitit 2025*

**6. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Fushë-Arrëz ka në administrim një fond pyjor dhe kullor prej 45,667.54 ha. Lista e inventarit të pyjeve dhe kullotave është miratuar me VKM nr.433 datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, të ndryshuar. Bashkia Fushë-Arrëz nuk ka hartuar plane mbarështimi për ekonominë pyjore në kundërshtim me nenin 17 të ligjit nr.57/2020 “Për Pyjet” si dhe nuk ka regjistruar në regjistrat kadastralë sipërfaqet e fondit pyjor dhe kullor publik në kundërshtim me pikën 66 të VKM nr.443/2016 nuk. Në Zyrën Vendore të ASHK Pukë rezultojnë se janë çelura kartela të pasurive të paluajtshme për 3217 pasuri pyje dhe kullota, për të cilat Bashkia Fushë-Arrëz nuk ka aplikuar për certifikatë pasurie, me arsyetimin për mungesë fondesh të planifikuara për këtë qëllim gjatë vitit 2024. (Më hollësisht trajtuar në pikën .3, faqe 23-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1.Rekomandimi:** Bashkia -Fushë Arrëz të marrë masa për të planifikuar fonde me qëllim hartimin e planeve të mbarështimit për ekonominë pyjore si dhe të aplikojë për pajisjen me certifikata pronësie, duke i dhënë përparësi ngastrave pyjore për të cilat janë lidhur kontrata për dhënie në përdorim të fondit pyjor.

#### Menjëherë

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi është konstatuar se për pasuri të paluajtshme të ndërtuara me investime nga Bashkia Fushë-Arrëz për periudhën 2015-2024, janë gjithsej dy objekte të cilat nuk janë regjistruar në regjistrat e pasurive publike, konkretisht si vijon:

- Palestra e shkollës së mesme, me sipërfaqe 458 m<sup>2</sup> me vlerë investimi 49,554,052 lekë, shtrihet në pasurinë me nr. 51, vol.3 faqe 245 me sipërfaqe 3890 m<sup>2</sup> truall në pronësi shtet. Ky objekt është ndërtuar me leje ndërtimi nr.6 datë 03.07.2019 por Bashkia nuk ka regjistruar truallin funksional të objektit e për rrjedhojë nuk mund të realizohet regjistrimi në kadastër.

- Godina e njësisë administrative Blerim me sipërfaqe 118.8 m<sup>2</sup> me vlerë investimi 5,628,804 lekë nuk ka leje ndërtimi si dhe nuk ka asnjë informacion juridik për statusin e truallit ku është zhvilluar ndërtimi për rrjedhojë nuk mund të realizohet regjistrimi në kadastër. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 12, të ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën .2 , faqe 26-44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1.Rekomandimi:** Bashkia Fushë Arrëz të marrë masa ligjore dhe administrative për të regjistruar në regjistrat publikë të pasurive të paluajtshme të ASHK-së, palestrën e shkollës së mesme dhe godinën e njësisë administrative, së bashku me truallin përkatës funksional.

#### Menjëherë

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2024 me të ardhurat e veta (pa transfertën e pakushtëzuar) të Bashkisë Fushë Arrëz nuk ka diferenca negative me vlerën e planifikuar madje është tejkaluar. Të ardhurat për vitin 2024 të planifikuara janë 28,555 mijë lekë ndërsa realizimi i tyre është 45,553 mijë lekë ose 159.5%.

Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara është në vlerën 108,984 mijë lekë, ndërsa planifikimi është në vlerën 136,518 mijë lekë ose 27,534 mijë lekë më pak.

Ky mosrealizim i investimeve të planifikuara, vjen si rezultat i mos planifikimeve saktë të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifave vendore si edhe të mungesës së një analize të argumentuar të të ardhurave krahasimisht me vitet e mëparshme, veprime në kundërshtim me nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, pika (a) të nenit 5. (Më hollësisht trajtuar në pikën .2.4, faqe 55-56, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1 Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore të marrë masa që:

-Gjatë hartimit të planit për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, të planifikojë saktë dhe bazuar në studime konkrete, analiza të hollësishme për secilin zë, duke marrë në konsideratë realizimin e të ardhurave të vitit të mëparshëm por edhe arkëtimet nga detyrimet e

prapambetura nga taksat dhe tarifat vendore nga vitet paraardhëse me qëllim pasqyrimin real të situatës të të ardhurave vjetore të bashkisë.

-Për secilin vit buxhetor, të mbajë të ndara për efekt planifikimi, të ardhurat e përfituara nga detyrimet e prapambetura, nga të ardhurat e përfituara nga taksat dhe tarifat vendore të vitit buxhetor aktual.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve, rezultoi se: Me *shkresën* nr. 623/7.Prot, datë 09.08.2024, nga Kontrolli i Lartë i Shtetit janë dërguar Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet të lëna sipas gjetjeve, për të cilat Bashkia Fushë Arrëz është shprehur për pranimin e rekomandimeve të lëna si dhe ka hartuar plan veprimin për zbatimin e tyre sipas *shkresës nr. 2621/Prot., datë 20.08.2024.* “Plan veprimi, për zbatimin e detyrave të lëna nga KLSH”, dërguar në KLSH, në përputhje me nenin 15 germa “j”, të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

-Bashkia Fushë Arrëz nuk ka dërguar raportim mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve në respektim të afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, veprime në kundërshtim me pikën 2 të nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

- Bashkia Fushë Arrëz nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm, pika 5.

a. Nga 7 masa organizative të rekomanduara, rezulton se 1 është zbatuar plotësisht, 4 masa të pazbatuara, 1 është në proces zbatimi dhe 1 masë pjesërisht e zbatuar.

b. Nga 4 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike si dhe uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara), rezultoi se:

*Nga 4 masa të rekomanduara, 1 masë e pazbatuar, 2 masa në proces dhe 1 masë zbatuar pjesërisht.*

c. Masa disiplinore, rezulton se janë zbatuar, duke u dhënë 4 vërejtje për 4 punonjës.

Bashkia Fushë Arrëz nuk ka marrë të gjithë masat e nevojshme për zbatimin e plotë të rekomandimeve.

-Niveli i pranimit të rekomandimeve është 100% dhe realizimi në masën 9 % zbatuar, pa zbatuar në nivelin 45,45%, në proces apo zbatuar pjesërisht në nivelin 45,45 % veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 dhe 30, pika 2 dhe Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, “Auditimi i jashtëm”, pika 5. (Më hollësisht trajtuar në pikën .3, faqe 44-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**9.1 Rekomandimi:** Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju ri kërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përshpejtimin e atyre në proces si më poshtë:

#### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**2.1.Rekomandimi:** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Fushë Arrëz të marrë masa për të krijuar një bazë të dhënash të plotë dhe të saktë për familjet, ku të përcaktohet numri i familjeve dhe sasia e sipërfaqes së banimit që ka secila familje si dhe të bëhet një analizë e hollësishme për planifikimin sa më real të të ardhurave për të mos krijuar diferenca të dukshme në realizimin e shpenzimeve buxhetore.

**4.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës dhe të marrë masa për të krijuar një inventar të integruar për ish-komunat dhe për të koordinuar me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës me qëllim miratimin e inventarëve përfundimtare dhe

regjistrimin e pasurive të paluajtshme.

**5.1.Rekomandimi:** Bashkia Fushë Arrëz të marrë masa për të krijuar një sektor të posaçëm për kadastrën, si pjesë të strukturës organike, me qëllim realizimin e detyrave për hartimin dhe përditësimin e inventarëve të pasurive të paluajtshme të bashkisë, përfshirë ish-komunat, aktualisht njësi administrative.

**3.1 Rekomandimi:** Zyra e Shërbimeve Publike të marrë masa për pajisjen me autorizimet përkatëse të të gjithë subjekteve që operojnë në fushën e tregtimit të hidrokarbureve dhe pas plotësimit të dosjeve përkatëse me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, të rakordojë me zyrën e Taksave dhe të Ardhurave Vendore për përlllogaritjen dhe vjeljen e detyrimeve nga pajisja me autorizime.

**B.I. Masa për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia.**

**1.1.Rekomandimi:** Sektori i Taksave, dhe Tarifave në Bashkinë Fushë Arrëz, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifatat vendore në fund të vitit 2023 në vlerën **21,319,900 lekë**, duke ndjekur etapat si më poshtë vijon:

*a-T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare.*

*b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme),.*

*c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.*

*d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Sektori i Taksave dhe Tarifave dhe Sektori Juridik, të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.*

**2.1.Rekomandimi:** Bashkia Fushë Arrëz të marrë të gjitha masa ligjore dhe administrative për arkëtimin e vlerës prej 2,119,232 lekë për debitorët që rezultojnë nga kontratat e qirasë së fondit pyjor.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

## **B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” u konstatua se kjo llogari vazhdon në rritje në vite të njëpasnjëshme në vlera të konsiderueshme e cila progresivisht në 31.12.2024 është në shumën totale prej 298,885,945 lekë. Kjo vlerë përbëhet nga:

- debitorë nga mos përputhshmëritë e konstatuara në auditimet e mëparshme, në vlerën **240,814,111 lekë**,
- debitorë tatime dhe taksa vendore, në vlerën **51,884,950 lekë**, e përberë nga
  - ✓ debitorë: tatimet dhe taksat në vlerën 23,476,511 lekë;
  - ✓ Debitorë; institucione publike në vlerën 2,097,926 lekë;
  - ✓ Debitorë për kontrata qiraje në vlerën 26,310,513 lekë.
- debitorë të transferuar nga ish-komunat, në vlerën prej **6,138,384 lekë**.
- detyrime për kopshtin dhe çerdhen në vlerën **48,500 lekë**.

Gjatë vitit 2024, zëri i cili ka pësuar ndryshime pra shtesa dhe pakësime ka qenë: debitorët në vite të tatim taksave, ku ka pasur shtesë të debitorëve me vlerën 5,123,540 lekë dhe pakësime me vlerën 1,734,133 lekë. Gjendja e këtij zëri, në vlerën 48,495,543 lekë, në 31.12.2023, është shtuar në fund të vitit 2024, në vlerën 51,884,950 lekë, *të ardhura të munguara në buxhetin e bashkisë Fushë*

**Arrëz, në vite** dhe vlera e shtuar e debitorëve vetëm për vitin 2024, është 5,123,540 lekë, **të cilat konsiderohen të ardhura të munguara në buxhetin e bashkisë Fushë Arrëz.**

Rezulton se sektori i taksave, dhe tarifave vendore në Bashkia Fushë Arrëz nuk ka llogaritur penalitete (kamatëvonesë), për mos likuidim në afat të detyrimeve si dhe nuk ka ndërmarrë asnjë procedurë për bllokimin e llogarive bankare, në kundërshtim me Kreun XI-Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni nenet 15 dhe 181 -Mospagimi i taksave dhe tatimeve, apo të parashikimit të vendimeve (vlerave) të gjobave të përcaktuara në nenin 46 të ligjit “Për Kundërvajtjet Administrative” (brenda 2 viteve), ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 -Mospagimi i taksave dhe tatimeve, me pikat 3,4, 5 dhe 5, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 26-44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1 Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Fushë Arrëz të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet dhe personat përgjegjës, që kanë sjellë mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Fushë Arrëz, në vlerën 298,885,945 lekë.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**1.2.Rekomandimi:** Sektori i Taksave, dhe Tarifave në Bashkinë Fushë Arrëz, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët e rinj, në vlerën 5,123,540 lekë dhe monitorimin e tyre në respektim të afateve për vazhdimin me masa të tjera shtrënguese në rast mos arkëtimit të këtyre detyrimeve.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**1.3 Rekomandimi:** Për debitorët në tatime dhe taksa në vlerën e mbetur prej 46,761,410 lekë, të cilëve u është dërguar njoftim vlerësimi nisur edhe nga analizimi i “moshës” së borxhit, të ndiqen të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve, duke:

- angazhuar strukturat e sektorit të tatim taksave për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare, subjektet, nuk rezultojnë të paguajnë detyrimet, në vite, Sektori i tatim taksave në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**1.4 Rekomandimi:** Për debitorët në vlerën 240,814,111 lekë, Sektori Juridik, të marrë masa:

-T'i dërgojë bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.

-Të dërgojë në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

-Të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT